



Smart N9
Manuali i përdorimit

Përmbajtja


1	Telefoni yt.....	4
1.1	Tastet dhe lidhjet.....	4
1.2	Fillimi	7
1.3	Ekrani kryesor	9
2	Shkrimi i tekstit.....	19
2.1	Përdorimi i tastierës në ekran	19
2.2	Redaktimi i tekstit.....	20
3	Telefonata, Regjistri i thirrjeve dhe Kontaktet...21	
3.1	Telefonata.....	21
3.2	Të fundit	29
3.3	Kontaktet.....	29
4	Mesazhet dhe emaili	36
4.1	Mesazhet	36
4.2	Gmail	40
5	Kalendari, Ora e alarmit dhe Makina llogaritëse	43
5.1	Kalendari.....	43
5.2	Ora	44
5.3	Makina llogaritëse.....	47
6	Lidhja	50
6.1	Lidhja me internetin.....	50
6.2	Chrome.....	52


6.3	Lidhja me pajisje me Bluetooth	53
6.4	Lidhja me kompjuterin përmes USB-së	54
6.5	Për të hequr pa rrezik kartën microSD nga telefoni.....	55
6.6	Ndarja e lidhjes së të dhënave celulare të telefonit.....	56
6.7	Lidhja me rrjete private virtuale	57
7	Google Play Store	59
8	Aplikacione multimediale	60
8.1	Kamera.....	60
8.2	Galeria	63
8.3	Luaj muzikë.....	66
9	Hartat.....	69
9.1	Gjej vendndodhjen time	69
9.2	Kërko për një vendndodhje.....	70
9.3	Ruaj një vendndodhje	70
9.4	Hap Street View për një vendndodhje.....	71
9.5	Merr drejtime për drejtim mjeti, transport ose drejtime për ecje.....	71
10	Të tjerat	72
10.1	Skedarët	72
10.2	Regjistruesi i zërit.....	72
10.3	Radio.....	72

11	Cilësimet.....	74
11.1	Rrjeti dhe interneti.....	74
11.2	Pajisjet e lidhura.....	76
11.3	Aplikacionet dhe njoftimet	77
11.4	Bateria	77
11.5	Ekrani.....	78
11.6	Tingulli.....	79
11.7	Hapësira ruajtëse.....	80
11.8	Siguria dhe vendndodhja	81
11.9	Kufizimet prindërore	83
11.10	Përdoruesit dhe llogaritë	85
11.11	Qasja	85
11.12	Google.....	87
11.13	Sistemi	88
11.14	Përditësimet e softuerit.....	92
12	Përditëso programin e telefonit	94
13	Piktogramet dhe simbolet grafike	95
14	Informacion rregullator.....	98
15	Informacioni i garancisë.....	110
16	Aksesorët.....	112
17	Specifikime	113

1 Telefoni yt

1.1 Tastet dhe lidhjet





Tasti i aplikacioneve të fundit

- Prek: tregon aplikacionet e përdorura së fundi. Prek një aplikacion për ta hapur ose rrëshqite majtas ose djathtas për ta hequr nga lista.
- Shtypje e gjatë: kjo të lejon të ndash ekranin në dy pjesë dhe të lejon të zgjedhësh një aplikacion tjetër të fundit për ta përdorur në të njëjtën kohë. Shënim: jo të gjitha aplikacionet funksionojnë në regjimin me ekran të ndarë.



Tasti i ekranit kryesor

- Ndërkohë që je në ndonjë aplikacion apo ekran, prek butonin e ekranit Kryesor për t'u kthyer në ekranin Kryesor.
- Shtyp gjatë këtë tast për të hyrë te Google Assistant Go.



Tasti i kthimit pas

- Prek për t'u rikthyer në pamjen e mëparshme të ekranit ose për të mbyllur një dritare dialoguese, menynë e opsioneve, panelin Njoftimet, etj.



Tastet e volumit

- Gjatë një telefonate, këto taste shërbejnë për rregullimin e volumit të kufjeve.
- Në regjimin e muzikës/videove/transmetimit, këto taste shërbejnë për rregullimin e volumit të medias.
- Këto taste shërbejnë gjithashtu për rregullimin e volumit të melodisë.
- Vendos në heshtje zilen e një thirrjeje hyrëse.



Tasti i ndezjes


- Shtyp dhe mbaj shtypur: Ndezja/fikja.
- Shtyp: aktivizon bllokimin e ekranit/aktivizon ekranin.
- Shtypje e gjatë: tregon menynë kërcyese për të zgjedhur nga **Fikje, Rindezje, Regjistrimi i ekranit, Regjimi i fluturimit**.
- Shtyp gjatë tastin **Ndezje** dhe tastin **Volumi poshtë** për të bërë një foto të ekranit.
- Në disa raste mund të lëvizësh poshtë pamjes së ekranit për të zgjedhur se cila pjesë do të regjistrohet. Prek  për të lëvizur ekranin e telefonit, më pas do të ruhet automatikisht.

1.2 Fillimi

1.2.1 Konfigurimi

Vendosja ose heqja e kartës SIM/kartës microSD

Për të kryer telefonata duhet të fusësh kartën SIM.




Fut kunjin në vrimë dhe tërhiq mbajtësen. Vendos kartën SIM ose microSD në mbajtëse me qarkun për poshtë dhe fute mbajtësen në folenë e vet. Sigurohu që ajo është futur si duhet. Për të hequr kartën SIM apo microSD, tërhiq mbajtësen.



Telefoni mbështet vetëm karta nano SIM. Mos u përpiq të fusësh lloje të tjera SIM si kartat mini apo mikro, pasi mund të dëmtosh telefonin.

Karikimi i baterisë



Për të karikuar baterinë, lidh karikuesin me telefonin dhe fute në prizë. Gjithashtu mund të karikosh telefonin nëpërmjet një kabllaje USB.



Për të reduktuar konsumin e energjisë së telefonit, fik Wi-Fi, GPS, Bluetooth ose aplikacionet që funksionojnë në sfond kur nuk nevojiten. Te Cilësimet mund të ulësh nivelin e ndriçimit të ekranit dhe të shkurtosh kohën përpara se ekranin të kalojë në fjetje.

1.2.2 Ndezja e telefonit

Mbaj shtypur tastin **Ndezje** derisa telefoni të ndizet. Mund të kalojnë disa sekonda deri në ndezjen e ekranit. Rrëshqit për të shkyçur telefonin ose përdor kodin PIN, Fjalëkalimin, Motivin nëse e ke konfiguruar këtë tashmë.

Nëse nuk di kodin PIN të kartës SIM ose nëse e ke harruar, kontakto me operatorin e rrjetit. Mos e lër kodin PIN pranë telefonit. Ruaje këtë informacion në një vend të sigurt kur ai nuk është në përdorim.

Konfigurimi i telefonit për herë të parë

Herën e parë kur ndez telefonin, do të të kërkohet të caktosh opsionet e mëposhtme: gjuhën, të dhënat celulare, datën dhe orën etj.

1. Zgjidh gjuhën e telefonit, pastaj prek **FILLO**.
2. Fut një kartë SIM ose prek **KAPËRCE**.
3. Zgjidh një rrjet Wi-Fi ose prek **KAPËRCE** dhe më pas **VAZHDO**.
4. Rregullo **Datën dhe orën** nëse nevojitet, më pas prek **TJETËR**.
5. Fut **Emrin**, më pas prek **TJETËR**.
6. Kyç telefonin me gjurmën e gishtit, më pas prek **TJETËR** ose **KAPËRCE**.
7. Mbro telefonin, cakto tani kyçjen e ekranit ose prek **Jo tani** dhe më pas prek **KAPËRCEJE GJITHSESI**.
8. Prek çelësin  aktiv/joaktiv për të zgjedhur **shërbimet e Google**, pasi të mbarosh, më pas prek **PAJTOHEM**.
9. Përmirësoje telefonin duke dërguar të dhëna anonime diagnostikuese dhe të përdorimit, prek **TJETËR**.

10. Konfiguro funksione të mëtejshme ose prek **JO, faleminderit** për konfigurimin në vijim.
11. Prek çelësin  aktiv/joaktiv për të aktivizuar/çaktivizuar shfaqjen e funksioneve dhe **Këshillat e ndihmës**, më pas prek **CAKTO TË GJITHA**.
12. Lexo më shumë paralajmërime rreth kësaj pajisjeje, përpara se ta përdorësh, më pas prek **U krye**.

Kur të konfigurohen edhe opsionet e tjera (**Madhësia e shkronjave, Madhësia e ekranit**, etj.), do të kesh konfiguruar plotësisht telefonin.

Nëse e nder telefonin pa futur kartën SIM, përsëri do të mund të lidhesh me një rrjet Wi-Fi për të hyrë në llogarinë tënde të Google dhe për të përdorur disa funksione.

1.2.3 Fikja e telefonit

Mbaj shtypur tastin **Ndezje** nga ekran i kryesor derisa të shfaqen opsionet e telefonit, më pas zgjidh **Fikje**.

1.3 Ekran i kryesor

Prekja e tastit **Kryesor** gjithmonë të dërgon tek ekran i kryesor dhe mund të personalizosh të gjitha ekranet Kryesore duke shtuar në to aplikacionet e preferuara, shkurtoret dhe miniaplikacionet.



Në ekranin standard Kryesor seti i ikonave të vendosura poshtë është gjithmonë i dukshëm, në cilëndo prej faqeve Kryesore ku ndodhesh. Kjo gjithashtu përfshin butonin Aplikacion, i cili do të tregojë të gjitha aplikacionet e disponueshme.

Shiriti i statusit

- Treguesit e statusit/njoftimeve
- Prek dhe zvarrit poshtë për të hapur panelin e Njoftimeve

Shiriti i Google Search

- Prek **a** për të hyrë te ekran i kërkimit me tekst
- Prek **b** për të hyrë te ekran i kërkimit me zë


→ Rrëshqit majtas ose djathtas për të parë panelet e tjera në ekranin kryesor

Aplikacionet në panelin e preferencave

- Prek për të hapur aplikacionin
- Shtyp gjatë për të lëvizur apo hapur më shumë opsione për aplikacionet

Skeda Aplikacioni

- Preke për të hapur të gjitha aplikacionet



Ekrani Kryesor zgjerohet në të dy anët për të mundësuar më shumë hapësirë për shtimin e aplikacioneve, shkurtoreve etj. Rrëshqit ekranin Kryesor horizontalisht majtas dhe djathtas për të parë pamjen e plotë të ekranit Kryesor.

Në ekranin standard kryesor, mund të rrëshqasësh djathtas për të hapur aplikacionet e tua të preferuara. Mund ta ndryshosh këtë për të hapur një aplikacion tjetër duke prekur **Cilësimet > Ekrani > Aplikacioni i preferuar i ekranit Kryesor**.

1.3.1 Përdorim i ekranit me prekje

Prek 

Për të hyrë te një aplikacion, preke me gisht.

Shtyp gjatë 

Shtyp gjatë ekranin Kryesor për të hapur opsionet e disponueshme për caktimin e sfondit.

Zvarrit 

Shtyp gjatë një objekt që të jesh në gjendje ta zvarrisësh atë në një vendndodhje tjetër.

Rrëshqit/Rrëshqit shpejt 

Rrëshqit gishtin në ekranin për të lëvizur lart dhe poshtë në lista, pamje aplikacionesh, foto, faqe interneti etj.

Goditja e lehtë 

E ngjashme me rrëshqitjen, por çokitja e bën të lëvizë më shpejt.

Afro gishtat/Largo gishtat 

Vendos gishtat e njërës dorë mbi sipërfaqen e ekranit dhe largoji ose bashkoji për të shkallëzuar një artikull në ekran.

Rrotullo 

Ndrysho automatikisht drejtimin e pamjes së ekranit nga vertikalisht në horizontalisht duke e kthyer telefonin anash.

1.3.2 Shiriti i statusit

Nga shiriti i statusit, mund të shohësh si statusin e telefonit (në të djathtë), ashtu edhe informacionin e njoftimeve (në të majtë).

Ikona e statusit

	GPRS e lidhur		GPS është aktivizuar
	EDGE e lidhur		Asnjë kartë SIM e futur
	3G e lidhur		Regjimi me dridhje
	4G e lidhur		Zilja është në heshtje
	HSDPA (3G) e lidhur		Regjimi Mos shqetëso
	HSPA (3G) e lidhur		Mikrofoni i telefonit është vendosur në heshtje
	Roaming i të dhënave		Bateria është shumë e ulët
	Fuqia e sinjalit		Bateria është e ulët
	Lidhur me rrjet Wi-Fi		Bateria është pjesërisht e zbrazur
	"Bluetooth" është aktivizuar		Bateria është plot
	Lidhur me një pajisje "Bluetooth"		Bateria po karikohet
	Regjimi i fluturimit		Kufja e lidhur
	Alarmi është vendosur		

Ikonat e njoftimeve

	Mesazh i ri në Gmail™		Thirrje e humbur
	Mesazh i ri me tekst ose multimedia		Thirrje në pritje
	Problem me dërgimin e SMS ose MMS		Transferimi i thirrjeve është aktivizuar
	Mesazh i ri Hangouts		Po ngarkohen të dhëna
	Postë e re zanore		Shkarkimi përfundoi
	Ngjarje e ardhshme		Po afron ose është tejkaluar pragu i përdorimit të të dhënave të operatorit
	Të dhënat po sinkronizohen		Disponohet një rrjet i hapur Wi-Fi
	Nuk është futur kartë microSIM		Radioja është ndezur
	Gabim në ekran		Disponohet përditësim i sistemit
	Ndarja e internetit me USB është aktivizuar		Lidhur me VPN
	Pika e hyrjes Wi-Fi e lëvizshme është aktivizuar		Roaming ndërkombëtar i aktivizuar
	Thirrje në vazhdim		Roaming ndërkombëtar i çaktivizuar

Paneli i njoftimeve

Prek dhe zvarrit poshtë shiritin e Statusit për të hapur panelin e Cilësimeve të shpejta dhe zvarrit poshtë përsëri për të hapur panelin e Cilësimeve të shpejta. Preke dhe zvarrite lart për ta mbyllur atë. Nga paneli i Njoftimeve, mund të hapësh artikuj dhe kujtues të tjerë të treguar nga ikonat e njoftimeve ose shfaq informacionin e shërbimit me valë.




Prek për të hapur **Shiritin e cilësimeve të shpejta**

Prek dhe zvarrit poshtë dy herë për të hapur **Shiritin e cilësimeve të shpejta**

Prek një njoftim dhe rrëshqite atë anash për ta hequr.

Prek **PASTRO TË GJITHA** për të pastruar të gjitha njoftimet e bazuara në ngjarje (njoftimet e tjera në vazhdim do të mbeten).

Prek ikonën e Cilësimeve  për të hyrë te **Cilësimet**.



Shiriti i cilësimeve të shpejta

- Prek ikonat për të aktivizuar/çaktivizuar funksionet ose për të ndryshuar regjimet

1.3.3 Shiriti i kërkimit

Telefoni ofron një funksion Kërkimi që mund të përdoret për të gjetur informacionin që dëshiron në telefon, në aplikacionet e tua ose në ueb.



a Kërko sipas tekstit

- Prek shiritin e kërkimit nga ekrani kryesor.
- Fut tekstin/ frazën për të cilën dëshiron të kërkosh.
- Prek  në tastierë nëse dëshiron të kërkosh në internet.

b Kërko me zë

- Prek  nga shiriti i kërkimit për të shfaqur ekranin dialogues.
- Thuaj fjalën/ frazën për të cilën dëshiron të kërkosh. Një listë me rezultatet e kërkimit do të shfaqet nga e cila mund të zgjedhësh.

1.3.4 Bllokimi/zhblllokimi i ekranit

Për të mbrojtur telefonin dhe privatësinë, mund ta kyçësh ekranin e telefonit me një larmi motivesh, PIN ose fjalëkalim etj. përmes **Cilësimet > Siguria dhe vendndodhja > Kyçja e ekranit**.


Për të krijuar një motiv zhblllokimi të ekranit (ndiq udhëzimet në ekran)

- Prek **Cilësimet > Siguria dhe vendndodhja > Bllokimi i ekranit > Motivi**.
- Vizato motivin tënd.

Vodafone   16:44

Choose your pattern

Pattern recorded



CLEAR

NEXT

Prek që të konfirmosh duke vizatuar përsëri motivin

Për të krijuar një PIN/Fjalëkalim për zhblokimin e ekranit

- Prek **Cilësimet** > **Siguria** > **Blokimi i ekranit** > **PIN** ose **Fjalëkalim**.
- Vendos kodin PIN tënd ose fjalëkalimin.


Për të kyçur ekranin e telefonit

Shtyp tastin **Ndezje** një herë për të kyçur ekranin.

Për të shkyçur ekranin e telefonit

Shtyp butonin **E ndezjes** një herë për të ndriçuar ekranin, vizato motivin e shkyçjes që ke krijuar ose fut PIN ose fjalëkalim për të shkyçur ekranin.

Nëse ke zgjedhur **Rrëshqitje** si kyçje ekrani, rrëshqit lart për të shkyçur ekranin.



1.3.5 Personalizimi i ekranit Kryesor

Shtimi i një aplikacioni ose miniaplikacioni

Prek butonin Aplikacionet (☰), pastaj shtyp gjatë aplikacionin ose miniaplikacionin për të aktivizuar regjimin Lëviz dhe zvarrite artikullin në një prej ekraneve Kryesore.

Rivendosja e një aplikacioni ose widget

Shtyp gjatë elementin që do të ripozicionosh për të aktivizuar regjimin "Lëviz", tërhiq artikullin në pozicionin e dëshiruar dhe pastaj lëshoje. Mund t'i zhvendosësh artikujt edhe në ekranin Kryesor, edhe në shiritin e Preferencave. Mbaje ikonën në cepin e majtë ose të djathtë të ekranit për ta zvarritur artikullin në një faqe tjetër të ekranit Kryesor.

Hiq

Shtyp gjatë objektin që dëshiron të heqësh për të aktivizuar regjimin Lëviz, tërhiq objektin lart tek ikona **Hiq** dhe lëshoje pasi objekti të bëhet i gri.

Krijimi i dosjeve

Për të lehtësuar organizimin e aplikacioneve dhe shkurtoreve në ekranin kryesor dhe në shiritin e preferencave, mund t'i shtosh ato në një dosje duke i vendosur artikujt njëri mbi tjetrin. Për ta riemërtuar dosjen, hape atë dhe preke hapësirën e emrit të dosjes për të futur emrin e ri.

Personalizimi i sfondit të ekranit

Shtyp gjatë hapësirën e zbrazët në ekranin Kryesor ose shko te **Cilësimet > Ekran** > **Sfondi** për të personalizuar Sfondin.

1.3.6 Rregullimi i volumit

Përdorimi i tastit të volumit

Shtyp tastin **Volumi** për të rregulluar volumin. Për të aktivizuar regjimin dridhje, shtyp tastin **Volumi poshtë** derisa telefoni të dridhet. Shtyp tastin **Volumi poshtë** edhe një herë për të aktivizuar regjimin pa zë.

Përdorimi i menysë së cilësimeve

Zvarrit poshtë dy herë nga paneli i njoftimeve dhe prek ikonën e cilësimeve  për të hapur **Cilësimet**, pastaj prek **Tingulli**. Mund të caktosh volumin e melodisë, mediave, njoftimeve etj. sipas preferencave të tua.

2 Shkrimi i tekstit

2.1 Përdorimi i tastierës në ekran


Cilësimet e tastierës virtuale

Prek skedën e aplikacioneve në ekranin kryesor, zgjidh **Cilësimet > Sistemi > Gjuha dhe hyrja**.

Ndryshimi i orientimit të tastierës virtuale

Ktheje telefonin anash ose vertikalisht për të rregulluar orientimin e tastierës virtuale. Mund dhe ta rregullosh duke ndryshuar cilësimet (shko te **Cilësimet > Ekranin > Rrotullo automatikisht ekranin**).

2.1.1 Tastiera e Google




2.2 Redaktimi i tekstit

Mund ta modifikosh tekstin që ke shkruar.

- Shtyp gjatë ose prek dy herë tekstin që dëshiron të redaktosh.
- Zvarrit skedat për të ndryshuar zgjedhjen e theksuar.
- Do të shfaqen opsionet në vijim: **PRIT, KOPJO, SHPËRNDAJ, ZGJIDH TË GJITHA.**

Gjithashtu mund të shtosh tekst të ri

- Prek ku do të shkruash ose shtyp gjatë një hapësirë bosh, kursori do të ndriçojë dhe skeda do të shfaqet. Zvarrit hapësirën për të lëvizur kursorin.
- Nëse ke zgjedhur ndonjë tekst, prek butonin për të shfaqur **NGJIT** që të lejon të ngjitesh çdo tekst që ke kopjuar më parë.




3 Telefonata, Registri i thirrjeve dhe Kontaktet

3.1 Telefonata




3.1.1 Kryerja e një thirrjeje

Për të bërë një telefonatë, shko tek ekrani Kryesor dhe prek ikonën e Telefonit  në shiritin Të preferuarat.



Historiku i thirrjeve
Kontaktet

Prek për të shfaqur
tastierën formuese



Shtyp gjatë
për të hapur
postën zanore

Formo numrin që dëshiron direkt nga tastiera ose zgjidh një kontakt nga **Kontaktet** ose **Historiku i telefonatave** duke prekur skedat, pastaj prek për të kryer telefonatën.

Numri që dhe mund të ruhet te **Kontaktet** duke prekur .

Nëse bën ndonjë gabim, mund t'i fshish shifrat e pasakta duke prekur .

Për të mbyllur thirrjen, prek .

Thirrjet ndërkombëtare

Për të formuar thirrje ndërkombëtare shtyp gjatë 0 për të futur "+", pastaj fut prefiksin ndërkombëtar të shtetit të ndjekur nga numri i plotë i telefonit dhe në fund prek .

Thirrja e urgjencës

Nëse telefoni yt ka mbulim nga rrjeti, formo numrin e urgjencës dhe prek për të bërë një telefonatë urgjence. Kjo funksionon edhe pa një kartë SIM dhe pa futur kodin PIN.

3.1.2 Përgjigjja ose refuzimi i një thirrjeje



Kur merr një thirrje, një dritare e thirrjeve do të paraqitet në krye të ekranit. Prek **REFUZIM** për të refuzuar një telefonatë ose **PËRGJIGJE** për t'iu përgjigjur telefonatës.

Prek dritaren e thirrjes për të hapur ekranin e Telefonatës.

Kur merr një thirrje në telefon, prek 

- Rrëshqit ikonën për lart për t'iu përgjigjur thirrjes;
- Rrëshqit ikonën për poshtë për ta refuzuar thirrjen;
- Rrëshqit ikonën  për lart për ta refuzuar thirrjen duke dërguar një mesazh të paracaktuar.

Për t'u çaktivizuar zërin thirrjeve hyrëse, shtyp tastin **Volumi lart/poshtë**.

3.1.3 Thirrja e postës zanore

Posta zanore është ofrohet nga rrjeti të shmangur humbje të thirrjeve. Punon si një sekretari telefonike që mund ta hapësh në çdo kohë.


Për të dëgjuar postën zanore, shtyp gjatë ¹ në skedën **Telefoni**.
o.o

Për të caktuar numrin e postës zanore, prek tastin **:** dhe prek **Cilësimet > Telefoni > Posta zanore**.

Nëse merr një postë zanore, një ikonë poste zanore **OO** do të shfaqet në shiritin e Statusit. Hap panelin e Njoftimeve, prek **Postë zanore e re**.

3.1.4 Gjatë një thirrje

Për të rregulluar volumin gjatë një thirrjeje, shtyp tastin **Volumi lart/poshtë**.



 Prek për të vendosur në pritje thirrjen e tanishme. Prek këtë ikonë përsëri për të rikthyer thirrjen.

 Prek për të shfaqur tastierën.

 Prek për të përfunduar thirrjen e tanishme.

 Prek për të heshtur thirrjen e tanishme. Prek këtë ikonë përsëri të bësh me zë thirrjen.

 Prek për të aktivizuar altoparlantin gjatë thirrjes së tanishme. Prek këtë ikonë përsëri të çaktivizosh altoparlantin.



Prek për të kryer një telefonatë të një kontakt tjetër.



Për të shmangur shtypjen aksidentale të ekranit gjatë një telefonate, ekрани do të kyçet automatikisht kur vendos telefonin në afërsi të veshit; dhe ai do të zhblllokohet kur telefoni i largohet veshit.

3.1.5 Menaxhimi i thirrjeve shumëfishe

Me këtë telefon mund të manovrosh thirrje shumëfishe në të njëjtën kohë.

Thirrje konferencë ⁽¹⁾

Mund të konfigurosh një thirrje konference.

- Kryej një thirrje pjesëtarit të parë të thirrjes konferencë.
- Prek
- Shkruaj numrin e telefonit të personit që dëshiron të shtosh në konferencë dhe prek . Gjithashtu mund të shtosh pjesëmarrës nga **THIRRJET** ose **KONTAKTET**.
- Prek për të nisur një thirrje konferencë.
- Gjatë një thirrje konferencë, prek për të hequr një pjesëmarrës ose për të folur privatisht me një nga pjesëmarrësit. Prek për ta hequr pjesëmarrësin nga konferenca, ose prek për të folur privatisht me pjesëmarrësin dhe për t'i kaluar në pritje pjesëmarrësit e tjerë.
- Prek për të përfunduar thirrjen konferencë dhe për të shkëputur të gjithë telefonuesit.

3.1.6 Cilësimet e thirrjes

Në ekranin e telefonit, prek tastin dhe zgjidh **Cilësimet**. Opsionet e mëposhtme janë të disponueshme:

⁽¹⁾ Në varësi të operatorit të rrjetit.

Shfaq opsionet

- **Rendit sipas**

Preke për të caktuar shfaqjen e kontakteve sipas Emrit ose Mbiemrit.

- **Formati i emrit**

Preke për të caktuar formatin e emrit me në fillim Emrin ose Mbiemrin.

Tingujt dhe dridhja

- **Zilja e telefonit**

Preke për të caktuar melodinë e telefonit.

- **Edhe dridhje për thirrje**

Prek  për të aktivizuar/çaktivizuar dridhjen kur lidhet thirrja.

- **Tingujt e tastierës**

Prek  për të aktivizuar/çaktivizuar tingujt e tastierës.

Përgjigjet e shpejta

Prek për të redaktuar përgjigjet e shpejta të cilat do të përdoren kur refuzon një thirrje me mesazhe.

Thirrjet

- **Numrat e thirrjeve fikse**

Numrat Formues të Fiksuar (NFF) është një regjim shërbimi i SIM, ku thirrjet dalëse kufizohen në një bashkësi numrash telefoni. Këta numra janë shtuar në listën FDN. Aplikacioni më i zakonshëm praktik i FDN është për prindërit për të kufizuar numrat e telefonit të cilët fëmijët e tyre mund të telefonojnë.

Për arsye sigurie, do të të kërkohet të aktivizosh FDN duke shtypur SIM PIN2 që zakonisht ofrohet nga operatori i shërbimit ose krijuesi i SIM.

- **Transferimi i thirrjes**

Preke për të konfiguruar nëse të transferohen gjithmonë thirrjet ose kur je i zënë, kur nuk përgjigjesh apo nuk je i arritshëm.

- **Bllokimi i thirrjeve**

Mund të aktivizosh ose çaktivizosh bllokimin e thirrjeve për thirrjet dalëse dhe hyrëse. Opsionet e ndryshme janë:

Të gjitha thirrjet dalëse

Bllokohen të gjitha thirrjet dalëse.

Thirrjet dalëse ndërkombëtare

Bllokohen thirrjet dalëse ndërkombëtare.

Telefonatat dalëse ndërkombëtare në roaming

Thirrjet dalëse ndërkombëtare bllokohen kur je jashtë shtetit.

Të gjitha thirrjet hyrëse

Bllokohen të gjitha thirrjet hyrëse.

Thirrjet hyrëse gjatë kohës që je në roaming

Thirrjet hyrëse bllokohen kur je jashtë shtetit.

Anulo të gjitha

Çaktivizo të gjitha bllokimet e thirrjeve.

Ndrysho fjalëkalimin e bllokimit

Ndrysho fjalëkalimin fillestar të bllokimit për aktivizimin e bllokimit të thirrjeve.

- **Cilësimet shtesë**

Identifikimi i thirrësit

Hap një kuti dialoguese ku mund të vendosësh nëse numri i telefonit shfaqet kur kryen thirrje.

Thirrja në pritje

Prek  për t'u njoftuar për thirrjet e reja hyrëse.

- **WiFi Calling ⁽¹⁾**

Prek  për të aktivizuar/çaktivizuar thirrjet përmes WiFi.

⁽¹⁾ Në varësi të vendit dhe operatorit.

Numrat e bllokuar

Prek **SHTO NJË NUMËR** për të qenë si numra të bllokuar dhe më pas nuk do të marrësh thirrje ose mesazhe prej tyre më.

Posta zanore

- **Njoftimet**

Prek për të caktuar njoftimet kur merret postë zanore.

- **Cilësimet e përparuara**

Shërbimi

Hap një kuti dialoguese ku mund të zgjedhësh shërbimin e postës zanore të operatorit ose një shërbim tjetër.

Konfigurimi

Nëse je duke përdorur shërbimin e postës zanore të operatorit, kjo hap një kuti dialoguese ku mund të fusësh numrin e telefonit për ta përdorur për të dëgjuar dhe menaxhuar postën zanore.

Qasja

- **Pajisjet e dëgjimit**

Prek  për të aktivizuar/çaktivizuar pajtueshmërinë me pajisjet e dëgjimit.

- **Reduktimi i zhurmës**

Prek  për të aktivizuar/çaktivizuar zhurmën në sfond gjatë thirrjeve.

ID-ja e telefonuesit dhe thirrjet e padëshiruara

Prek  aktivizo/çaktivizo **ID-ja e telefonuesit dhe thirrjet e padëshiruara** kur të marrësh thirrje.

Vendet në afërsi

Prek  për të aktivizuar/çaktivizuar **Vendet në afërsi**, që do të përdorin vendndodhjen tënde për të gjetur vende në afërsi që përkojnë me kërkesën tënde.

- **Rezultate të personalizuarra kërkimi**

Prek  për të aktivizuar/çaktivizuar funksionin **Rezultate të personalizuarra kërkimi**, që të përmirëson rezultatet nga historiku i kërkimit.

- **Llogaria e Google**

Prek për të shtuar llogarinë tënde të Google duke përdorur funksionin e **Vendet në afërsi**.

- **Cilësimet e vendndodhjes**

Preke për të marrë informacione të mëtejshme të cilësimeve të vendndodhjes.

3.2 Të fundit

Mund të shikosh historikun e thirrjeve duke prekur  nga ekrani i telefonit për të parë historikun e thirrjeve.

Prek një kontakt ose një numër për të parë informacionin ose për veprime të mëtejshme.

Mund të shikosh informacion të detajuar të një thirrjeje, mund të nisësh një thirrje të re ose të dërgosh mesazhe tek një kontakt ose numër ose shto numra te **Kontaktet** (vetëm në dispozicion për numrat e telefonit të pa ruajtur), etj.

Prek foton  për të shtuar numra te **Kontaktet**.

Për të pastruar të gjithë memorien e thirrjeve, prek tastin  nga ekrani i telefonit dhe prek **Pastro të shpeshtat**.


3.3 Kontaktet



Mund të shohësh dhe krijosh kontakte në telefon duke i sinkronizuar këto me kontaktet e tua të Gmail ose aplikacioneve të tjera në internet ose në telefon.

3.3.1 Shiko kontaktet e tua

Për të hapur aplikacionin **Kontaktet**, prek skedën e Aplikacionit në ekranin kryesor, pastaj zgjidh **Kontaktet**.



Prek ikonën për të hapur panelin e kontakteve të shpejta dhe për të parë informacionin e detajuar të kontaktit

Lista e kontakteve

Prek për të shtuar një kontakt të ri

Prek  tastin për të shfaqur menynë e opsioneve të listës së kontakteve.

Opsionet e mëposhtme janë të disponueshme:

Etiketat

Prek për të krijuar etiketë, që të lejon të shtosh kontakte në etiketë.

Llogaritë

Menaxho sinkronizimin e kontakteve në llogaritë në **Google**, **Telefon** dhe **SIM**.

Cilësimet

- **Informacionet e mia**

Konfiguro profilin tënd.

- **Llogaritë**

Menaxho cilësimet e sinkronizimit për llogari të ndryshme.

- **Llogaria bazë për kontakte të reja**

Menaxho llogarinë bazë për kontakte të reja.

- **Kontaktet për t'u shfaqur**

Zgjidh cilat kontakte të shfaqen.

- **Rendit sipas**

Preke për të caktuar shfaqjen e kontakteve sipas Emrit ose Mbiemrit.

- **Formati i emrit**

Preke për të caktuar formatin e emrit me në fillim Emrin ose Mbiemrin.

- **Emri fonetik**

Prek për të caktuar shfaqjen ose fshehjen e emrit fonetik.

- **Importo/Eksporto**

Importo ose eksporto kontakte ndërmjet telefonit, kartës SIM dhe kartës microSD ose ndaj kontaktet.

- **Numrat e bllokuar**

Shto numra si numra të bllokuar dhe më pas nuk do të marrësh thirrje dhe mesazhe prej tyre më.

- **Shfaq kapacitetin e kartës SIM**


Prek për të shfaqur numrin e kontakteve të ruajtur në kartën SIM.

- **Rreth kontakteve**

Shfaq informacion rreth kontakteve.

3.3.2 Shtimi i një kontakti

Prek butonin e Aplikacionit në Ekranin kryesor, zgjidh **Kontaktet**, pastaj prek ikonën  në listën e kontaktit për të krijuar një kontakt të ri.



Prek për ta ruajtur

Prek për të marrë një foto ose zgjidh një foto për kontaktin

Prek që të shtosh një etiketë

Kur të përfundosh, prek **RUAJ** për ta ruajtur.

Për të dalë pa e ruajtur, mund të prekësh dhe më pas **HIDH**.

Shto/hiq nga Të preferuarat

Për të shtuar një kontakt te të preferuarit, mund të prekësh një kontakt për të shfaqur detajet pastaj prek për të shtuar kontaktin te të preferuarit.

Për të hequr një kontakt nga të preferuarat, prek në ekranin e detajeve të kontaktit.



Vetëm kontaktet e telefonit dhe të llogarisë mund të shtohen te të preferuarat.

3.3.3 Redaktimi i kontakteve

Për të redaktuar informacionin e kontaktit, prek tastin në ekranin e detajeve të kontaktit. Kur të përfundosh, prek **RUAJ**.

Ndrysho numrin e parazgjedhur të telefonit të një kontakti

Numri i parazgjedhur i telefonit (numri që ka prioritet kur bëhet një thirrje ose kur dërgohet një mesazh) gjithmonë do të shfaqet poshtë emrit të kontaktit.

Për të ndryshuar numrin e telefonit të parazgjedhur, shtyp gjatë numrin që dëshiron të vendosësh si numrin e paracaktuar nga ekrani i detajeve të kontaktit, pastaj zgjidh **Vendos të paracaktuar**. Një  shfaqet përpara numrit.

Kjo zgjedhje është në dispozicion vetëm kur kontakti ka më shumë se një numër.

Fshirja e një kontakti

Për të fshirë një kontakt, prek  dhe prek **Fshi** nga ekrani i kontaktit (detaje).



Kontakti që ke fshirë do të hiqet edhe nga aplikacionet e tjera në telefon ose në internet herën tjetër që do të sinkronizosh telefonin.

3.3.4 Komunikimi me kontaktet e tua


Nga ekrani i detajeve të kontaktit mund të komunikosh me kontaktet duke bërë një thirrje ose duke dërguar një mesazh.

Për të nisur një thirrje, prek numrin e telefonit.

Për të dërguar një mesazh, prek ikonën  në anën e djathtë të numrit.

Përdorimi i Kontaktit të shpejtë për Android

Prek foton e kontaktit për të hapur Kontakt të Shpejtë për Android, pastaj mund të prekësh numrin ose ikonën  sipas mënyrës që dëshiron të lidhesh.



Ikonat e disponueshme në panelin Kontakt i Shpejtë varen nga informacioni që ke për kontaktin dhe aplikacionet/llogaritë në telefon.

3.3.5 Importimi, eksportimi dhe ndarja e kontakteve

Nga ekrani i kontakteve prek tastin  për të hapur menyën e opsioneve, prek **Cilësimet** pastaj prek **Importo** ose **Eksporto** për të importuar/eksportuar kontaktet nga/drejt kartës SIM, telefonit, kartës microSD, memories së telefonit, llogarive etj.

Për të importuar/eksportuar një kontakt të vetëm nga/në kartën SIM, zgjidh një llogari dhe kartën e synuar SIM, zgjidh kontaktin për t'u importuar/eksportuar dhe prek **OK** për ta konfirmuar.

Për të importuar/eksportuar të gjitha kontaktet nga/drejt kartës SIM, zgjidh një llogari dhe kartën SIM, prek **Zgjidh të gjitha** dhe prek **OK** për ta konfirmuar.

Mund të ndash një kontakt të vetëm ose kontakte me të tjerët përmes Bluetooth, Gmail, etj.

Për të bërë këtë, prek kontaktin që do të ndash, prek tastin  dhe **Ndaj** nga ekrani i detajeve të kontaktit, pastaj zgjidh aplikacionin për të kryer këtë veprim.

3.3.6 Shfaqja e kontakteve

Mund të konfigurosh cilin grup të kontakteve dëshiron të shfaqësh në listën Kontaktet. Prek tastin  pastaj prek **Cilësimet** dhe pastaj **Kontaktet për shfaqje** nga ekrani i listës së kontakteve, pastaj mund të zgjedhësh cilat kontakte të shfaqen.

Prek tastin  dhe më pas **Cilësimet**. Mund të **Rendisësh sipas Emrit** ose **Mbiemrit**, ashtu si dhe **Formatit të emrit** si Emri i pari ose Mbiemri i pari.

3.3.7 Bashkimi/Fshirja e kontakteve

Për të shmangur informacion e dubluar mund të shtosh lehtë detaje të kontakteve për një kontakt ekzistues.

Prek kontaktin të cilit dëshiron t'i shtosh informacion, prek tastin  pastaj prek tastin **:** në ekranin e redaktimit dhe prek **Lidh**.

Pastaj do të të kërkohet të zgjedhësh kontaktin informacionin e të cilit dëshiron të bashkosh me kontaktin e parë. Informacioni nga kontakti i dytë i shtohet të parit dhe kontakti i dytë nuk do të shfaqet më në listën e kontakteve.

Për të ndarë informacionin e kontaktit, prek kontaktin informacionin e të cilit dëshiron të ndash, prek tastin  pastaj prek tastin **:** në ekranin e modifikimit. Pastaj prek **Shfaq kontaktet e pëlqyera** dhe prek **HIQ LIDHJEN** për ta konfirmuar.

3.3.8 Sinkronizimi i kontakteve në disa llogari

Kontaktet, të dhënat dhe informacioni tjetër mund të sinkronizohet nga disa llogari, në varësi të aplikacioneve të instaluar në telefon.

Për të shtuar një llogari, prek  në shiritin e cilësimeve të shpejta për të arritur te **Cilësimet**, pastaj prek **Përdoruesit dhe llogaritë**.

Do të të kërkohet të zgjedhësh llojin e llogarisë që je duke shtuar, si Google, Exchange, etj.

Ashtu si me konfigurimet e llogarisë, duhet të fusësh informacion të detajuar, si emër përdoruesi, fjalëkalim, etj.

Mund të heqësh një llogari dhe të gjithë informacionin lidhur me të nga telefoni. Hap ekranin **Cilësimet**, prek llogarinë që do të fshish, pastaj prek **HIQ LLOGARINË** për ta konfirmuar.

Sinkronizo

Mund të sinkronizosh një llogari në ekranin **Përdoruesit dhe llogaritë**, prek  në krah të sinkronizimit automatik të të dhënave.

4 Mesazhet dhe emaili

4.1 Mesazhet



Mund të krijosh, redaktosh dhe të marrësh biseda, mesazhe SMS dhe MMS me telefonin tënd.

Shko te faqja kryesore dhe prek ikonën  në shiritin e të preferuarave (nëse ka) ose prek skedën e aplikacionit nga ekrani kryesor, pastaj prek .

4.1.1 Krijo një mesazh të ri

Në ekranin e listës së mesazheve, prek ikonën e mesazhit të ri  për të shkruar mesazhe të reja/multimedia.



- Prek për të parë të gjithë bashkëbisedimin e mesazhit
- Shtyp gjatë titujt e mesazheve për të hapur opsione të tjera të disponueshme me këtë kontakt.



Prek për të krijuar një mesazh të ri ose një bisedë të re në grup

Dërgimi i një mesazhi me tekst

Fut numrin e telefonit të marrësit në shiritin e marrësit ose prek  për të shtuar marrës, pastaj prek shiritin e përmbajtjes për të futur tekstin e mesazhit. Kur të mbaroni, prek  për të dërguar mesazhin me tekst.



Një SMS me më shumë se 160 karaktere faturohet si disa SMS. Germat specifike (p.sh. me theks) rrisin madhësinë e mesazhit SMS, gjë e cila mund të bëjë që marrësit t'i dërgohen disa SMS.

Dërgimi i një mesazhi multimedia

MMS mundëson të dërgosh videoklipe, imazhe, foto, animacione, prezantime dhe audio drejt telefonave të tjerë të përputhshëm dhe adresave të emailit.

Një SMS do të konvertohet në MMS automatikisht kur bashkëngjiten skedarët media (imazhe, video, audio, etj) apo shtohen subjekte ose adresa emaili.

Për të dërguar një mesazh multimedia, fut numrin e telefonit të marrësit në shiritin e marrësit, prek shiritin e përmbajtjes për të futur tekstin e mesazhit. Prek  për të hapur opsionet e bashkëngjities, zgjidh fotografi, vendndodhje, audio ose subjekte të tjera që dëshiron të shtosh si bashkëngjitje.

Kur të mbarosh, prek  për të dërguar mesazhin multimedial.

Opsionet e shtimit:



Prek për të zgjedhur emocionin si bashkëngjitje.



Prek për të bërë foto.



Shfaq Fotografitë, Galerinë ose Menaxherin e skedarëve për të zgjedhur një fotografi si bashkëngjitje.



Prek për të zgjedhur dhe shpërndarë vendndodhjen tënde.



Prek dhe mbaj regjistruetin e mesazheve zanore për të regjistruar një mesazh zanor për bashkëngjitje.

4.1.2 Menaxhimi i mesazheve

Kur mbërrin një mesazh i ri, një ikonë  shfaqet në shiritin e statusit si njoftim. Zvarrit poshtë shiritin e statusit për të hapur panelin e Njoftimeve, prek mesazhin e ri për ta hapur atë. Mund dhe të hapësh  dhe ta prekësh mesazhin e ri për ta hapur.

Mesazhet shfaqen si një bisedë.

Për t'iu përgjigjur një mesazhi, prek mesazhin aktual për të hyrë në ekranin e kompozimit të mesazhit, fut tekstin, pastaj prek .

Nëse shtyp gjatë një mesazh në ekranin e detajeve të mesazhit, opsionet e mëposhtme do të jenë të disponueshme:



Prek për të arkivuar mesazhin aktual.



Prek për të fshirë mesazhin aktual.



Prek për të vendosur në heshtje njoftimet e telefonit kur vjen mesazh i ri.



Prek blloko numrin aktual, dhe nuk do të marrësh thirrje ose mesazhe nga ai më.

4.1.3 Rregullo cilësimet e mesazhit

Në ekranin lista e mesazheve, prek tastin  dhe zgjidh **Cilësimet**.

Aplikacioni SMS i parazgjedhur

Prek për të ndryshuar aplikacionin e parazgjedhur për SMS.

Njoftimet

Prek  për të aktivizuar/çaktivizuar njoftimet për **Mesazhet**.

- **Rëndësia**

Prek për të zgjedhur llojet e njoftimit për mesazhet hyrëse.

- **Cilësimet e mëtejshme në aplikacion**

Prek për të caktuar cilësime të mëtejshme për **Mesazhet**.

Dëgjo tingujt e mesazheve dalëse

Prek  për të aktivizuar/çaktivizuar dëgjimin e tingujve të mesazheve kur dërgon mesazh.

Shteti yt aktual

Prek për të zgjedhur shtetin tënd aktual.

Të avancuara

- **Mesazhet në grup**

Shëno kutinë përzgjedhëse për të dërguar një mesazh të vetëm drejt disa marrësve.

- **Shkarkimi automatik i MMS-ve**

Prek  aktivizo/çaktivizo për të shkarkuar mesazhin e plotë MMS automatikisht në telefon.

- **Shkarkimi automatik i MMS-ve në roaming**

Prek  aktivizo/çaktivizo për të shkarkuar mesazhin e plotë MMS automatikisht në roaming.

- **Përdorimi i germave të thjeshta**

Prek  për të aktivizuar/çaktivizuar përdorimin e germave të thjeshta në mesazhet MMS.

- **Marrja e raporteve të dorëzimit të SMS-ve**

Prek  aktivizo/çaktivizo për të parë raportet e dorëzimit të SMS-ve kur dorëzohet mesazhi SMS.

- **Sinjalizimet e lidhjes me valë**

Prek për të hapur cilësimet e sinjalizimeve të lidhjes me valë.

- **Mesazhet e kartës SIM**

Prek për të parë mesazhet në kartën SIM.

- **Numri i telefonit**

Tregon numrin tënd të telefonit.

4.2 Gmail



Herën e parë që konfiguroni telefonin, mund të zgjedhësh të përdorësh një llogari ekzistuese Gmail ose të krijosh një llogari Emaili.

Si shërbim emaili bazuar në ueb i Google, Gmail është konfiguruar kur konfiguroni telefonin. Gmail në telefon mund të sinkronizohet automatikisht me llogarinë tënde të Gmail në ueb. Ndryshe nga lloje të tjera llogari emaili, çdo mesazh dhe përgjigjet e tij në Gmail grupohen në kutinë postare si një bisedë e vetme; gjithë emaili organizohet në etiketa në vend të dosjeve.

Për të hapur Gmail

Nga ekrani Kryesor, prek tastin Aplikacion për të hyrë në listën e aplikimeve, pastaj prek **Gmail**.

Gmail shfaq mesazhe dhe biseda nga një llogari e vetme e Gmail-it njëkohësisht. Nëse zotëron më shumë se një llogari, mund të shtosh një llogari duke prekur  ikonën dhe zgjidh **Cilësimet** nga ekrani Kutia marrëse, pastaj prek **Shto llogari**. Përveç llogarisë së Gmail, mund të shtosh ose konfigurosh gjithashtu llogari të jashtme emaili duke zgjedhur Personal (IMAP/POP) ose Exchange. Kur të përfundosh, mund të kalosh në një llogari tjetër duke prekur emrin e llogarisë nga ekrani Kutia marrëse, pastaj përzgjidh llogarinë që dëshiron të shfaqësh.

Krijimi dhe dërgimi i emaileve

- 1 Prek  nga ekrani i Kutisë hyrëse.
- 2 Fut adresën e emailit të marrësit në fushën **Për**.
- 3 Nëse është e nevojshme, prek ikonën e menysë kërcyese  **Shto Cc/Bcc** për të shtuar një kopje ose një kopje negative të mesazhit.
- 4 Vendos subjektin dhe përmbajtjen e mesazhit.
- 5 Prek ikonën  dhe zgjidh **Bashkëngjit skedar** për të shtuar një bashkëngjitime.
- 6 Në fund, prek ikonën  për ta dërguar.
- 7 Nëse nuk do ta dërgosh emailin menjëherë, mund të prekësh  ikonën dhe pastaj **Ruaj skicën** ose prek tastin **Prapa** për të ruajtur një kopje. Për të shfaqur skicën, prek emrin e llogarisë për të shfaqur gjithë emërtimet, pastaj zgjidh **Skica**.

Nëse nuk dëshiron të dërgosh ose ruash emailin, mund të prekësh ikonën  dhe pastaj prek **Hidh**.

Për të shtuar një nënshkrim te emailat, prek ikonën  dhe pastaj prek **Cilësimet** nga ekrani i Kutisë marrëse, zgjidh një llogari dhe pastaj prek **Nënshkrimi**.

Për të marrë dhe lexuar emailët

Kur vjen një emaili i ri, do të njoftohesh nga një zile ose dridhje, dhe një ikonë  do të shfaqet në shiritin e Statusit.

Zvarrit poshtë shiritin e statusit për të shfaqur panelin e Njoftimeve, prek postën e re për ta hapur atë. Ose gjithashtu mund të hapësh etiketën Kutia marrëse e Gmail dhe prek mesazhin e ri për ta lexuar atë.

Mund të kërkosh një email sipas dërguesit, marrësit, subjektit, etj.

- Prek ikonën  nga ekrani Kutia hyrëse.
- Fut fjalën kyç që dëshiron të kërkosh në kutinë e kërkimit dhe prek  në tastierën e softuerit.

Për të kthyer përgjigje ose transferuar emailët

• Përgjigju

Kur shfaq një email, prek  për t'iu përgjigjur.

• Përgjigju të gjithëve

Prek  pranë  dhe zgjidh **Përgjigju të gjithëve** për të dërguar mesazh te të gjithë personat në një zinxhir emaili.

• Transfero

Prek  pranë  dhe zgjidh **Transfero** për t'ua përcjellë mesazhin e marrë njerëzve të tjerë.

5 Kalendari, Ora e alarmit dhe Makina llogaritëse

5.1 Kalendari




Përdor kalendar për të ndjekur mbledhjet e rëndësishme, takimet, etj.

Për të hapur këtë funksion, prek tastin e Aplikacionit nga ekrani kryesor, pastaj prek **Kalendari**.

5.1.1 Shfaqje me shumë mënyra

Për të ndryshuar pamjen e Kalendarit, prek titullin e datës për të hapur pamjen e muajit ose prek ≡ dhe zgjidh **Programi**, **Dita**, **3-ditë**, **Javë** ose **Muaj**. Prek ikonën  për t'u kthyer në pamjen Sot.



5.1.2 Për të krijuar ngjarje të reja

Mund të shtosh ndodhi të reja nga çdo shfaqje e Kalendarit.

- Prek .
- Plotëso të gjithë informacionin e kërkuar për këtë ngjarje të re. Nëse ajo është ngjarje një ditore, mund të zgjidh **Gjithë ditën**.

Pasi të mbarosh, prek **RUAJ** nga kreu i ekranit.



Para se të mund të shtosh një ngjarje, duhet të kesh të paktën një llogari Kalendar dhe të bësh një kalendar të dukshëm.

Për të fshirë ose redaktuar një ngjarje

Për ta modifikuar apo fshirë një ngjarje, prek ikonën  për të modifikuar ngjarjen dhe prek **Fshi** për të fshirë një ngjarje.

5.1.3 Kujtesë ngjarjeje

Nëse është vendosur një kujtesë për një ngjarje, ikona e ngjarjes së ardhshme  do të shfaqet në shiritin e statusit si një njoftim, kur të arrijë koha e kujtesës.

Prek dhe zvarrit poshtë shiritin e statusit për të hapur panelin e Njoftimeve, prek emrin e ngjarjes për të parë listën e njoftimeve në Kalendar.

Prek tastin **Prapa** për të mbajtur kujtesat në pritje në shiritin e statusit dhe panelin e njoftimeve.

5.2 Ora



Telefoni celular ka një orë të integruar.

Për të hapur këtë funksion, prek tastin e Aplikacionit nga ekrani kryesor, pastaj prek **Ora**.

Prek  për të shtuar ose vendosur një alarm.

5.2.1 Për të vendosur një alarm

Nga ekrani **Ora**, prek  për t'u futur në ekranin **Alarmet**, pastaj prek  për të shtuar një alarm të ri. Opsionet vijuese do të shfaqen:

- **Ora**

Prek numrat për të vendosur orarin e alarmit.

Prek  pranë orës që cakton për të aktivizuar/çaktivizuar këtë alarm.

- **Përsërit**

Shëno kutinë e kontrollit për të aktivizuar **Përsërit**, më pas mund të prekësh për të përzgjedhur ditët që dëshiron alarmin të funksionojë.

- **Zilja**

Prek për të vendosur një zile alarmi.

- **Dridhje**

Shëno kutinë e kontrollit për të aktivizuar/çaktivizuar vibrimin.

- **Etiketa**

Prek për të vendosur emërtimin për alarmin.

Prek një alarm ekzistues dhe prek  për të fshirë alarmin e zgjedhur.

5.2.2 Për të rregulluar cilësimet e alarmit

Prek tastin  nga ekrani **Ora**. Opsionet në vijim do të jenë të disponueshme nën **Cilësimet**:

Ora

- **Stili**

Prek për të vendosur stilin **Analog** ose **Dixhital**.

- **Shfaqja e orës me sekonda**

Prek për ta caktuar  ta shfaqë orën me sekonda.

- **Ora automatike lokale**

Prek për të ndërruar  për të vendosur orën lokale kur udhëton jashtë.

- **Zona e orës lokale**

Prek për të vendosur zonën e orës lokale.

- **Ndrysho datën dhe orën**

Prek për të vendosur datën dhe orën.

- **Ora e natës**

Prek për të aktivizuar orën e natës.

Alarmit

- **Zgjimi i pajisjes**

Prek për të ndërruar  për të aktivizuar tingullin e Alarmit edhe nëse telefoni është i fikur.

- **Heshtje pas**

Prek për të vendosur kohën e heshtjes.

- **Periudha e dremitjes**

Prek për të zgjedhur periudhën e dremitjes.

- **Volumi i alarmit**

Prek për të vendosur volumin e alarmit.

- **Rrit gradualisht volumin**

Prek për të vendosur rritjen graduale të volumit.

- **Butonat e volumit**

Prek për të zgjedhur **Pezullo**, **Largo** apo **Mos bëj asgjë** si butona të volumit.

- **Fillo javën në**

Prek për të zgjedhur ditën e parë të javës sipas preferencës nga **E shtunë**, **E dielë** ose **E hënë**.

Kohëmatësit

- **Tingulli i kohëmatësit**

Prek për të zgjedhur tingullin e kohëmatësit.

- **Rrit gradualisht volumin**

Prek për të vendosur rritjen graduale të volumit.

- **Dridhja e kohëmatësit**

Prek për të caktuar  për të aktivizuar dridhjen për kohëmatësin.

5.3 Makina llogaritëse



Me Makinën llogaritëse mund të zgjidhësh shumë probleme matematikore.

Për ta hapur atë, prek butonin e Aplikacionit nga ekrani Kryesor, pastaj prek **Makina llogaritëse**.

Prek , ka dy panele në dispozicion: Paneli Bazë dhe paneli i Avancuar.

Për të ndryshuar midis paneleve, zgjidh një nga dy rrugët që vijnë:


- Prek dhe Zvarrit ekranin bazë për majtas ose prek  për të hapur panelin e përparuar.
- Ose ktheje telefonin në regjim panoramik nga paneli bazë për të hapur panelin Të avancuara ⁽¹⁾.

⁽¹⁾ Nëse "**Cilësimet\Ekrani\Rrotullo automatikisht ekranin**" është joaktiv, ky artikull nuk do të shfaqet.


Për të shfaqur historinë e llogaritjeve, tërhiq poshtë ekranin.

Vodafone 19:52


Vodafone 19:52



Prek €, më pas hap panelin e këmbimit valutor.



Prek , më pas hap panelin e këmbimit të njësive.



6 Lidhja

Telefoni mund të lidhet në internet duke përdor GPRS/EDGE/3G/4G ose Wi-Fi.

6.1 Lidhja me internetin

6.1.1 GPRS/EDGE/3G/4G

Herën e parë që ndez telefonin me kartën SIM brenda, ajo do të konfigurojë automatikisht shërbimin e rrjetit celular: GPRS, EDGE, 3G ose 4G. Nëse rrjeti nuk është lidhur, mund të aktivizosh **Të dhënat celulare te Cilësimet > Rrjeti dhe interneti > Përdorimi i të dhënave.**

Për të kontrolluar lidhjen e rrjetit që po përdor, prek skedën e aplikacionit në ekranin kryesor, pastaj prek **Cilësimet > Rrjeti dhe interneti > Rrjeti celular > Emrat e pikës hyrëse ose Operatorët e rrjetit.**

Për të krijuar një pikë të re hyrjeje

Një lidhje e re rrjeti celular mund t'i shtohet telefonit me hapat e mëposhtëm:

- 1 Prek  në shiritin e cilësimeve të shpejta për të arritur te **Cilësimet.**
- 2 Prek **Rrjeti dhe interneti > Rrjeti celular > Emrat e pikës hyrëse.**
- 3 Pastaj prek tastin  për të shtuar një APN të re.
- 4 Fut informacionin e kërkuar për APN.
- 5 Kur të përfundon, prek tastin  dhe **Ruaj.**

Për të aktivizuar/çaktivizuar të dhënat roaming


Gjatë roaming, mund të vendosësh të lidhesh/shkëputesh nga shërbimi i të dhënave.

- 1 Prek  në shiritin e cilësimeve të shpejta për të arritur te **Cilësimet.**
- 2 Prek **Rrjeti dhe interneti > Rrjeti celular.**

3 Prek çelësin  për të aktivizuar ose çaktivizuar të dhënat roaming.

4 Kur të dhënat në roaming janë çaktivizuar, ende mund të kryesh shkëmbim të të dhënave me një lidhje Wi-Fi (shih "**6.1.2 Wi-Fi**").

Kur je jashtë vendit, një panel fiks do të shfaqet në shiritin e njoftimit për të lejuar të aktivizosh ose çaktivizosh shërbimin.



6.1.2 Wi-Fi

Mund të lidhesh me internetin kur telefoni është brenda zonës së mbulimit të një rrjeti me valë. Wi-Fi mund të përdoret në telefon edhe pa e futur kartën SIM.

Aktivizimi i Wi-Fi dhe lidhja me një rrjet me valë

1 Prek  në shiritin e cilësimeve të shpejta për të arritur te **Cilësimet**, pastaj prek **Rrjeti dhe interneti > Wi-Fi**.

2 Prek çelësin  për të aktivizuar/çaktivizuar Wi-Fi.

3 Aktivizo Wi-Fi: informacionet e detajuara për të gjitha rrjetet e gjetura Wi-Fi shfaqen në seksionin e rrjeteve Wi-Fi.

- 4 Prek një rrjet Wi-Fi për t'u lidhur me të. Nëse rrjeti që ke zgjedhur është i sigurt, do të fusësh një fjalëkalim apo kredenciale tjera (kontakto me operatorin e rrjetit për detaje). Kur të përfundosh, prek **LIDHU**.

Për të shtuar një rrjet Wi-Fi

Kur Wi-Fi është i ndezur, mund të shtosh rrjete të reja Wi-Fi.

- 1 Prek  në shiritin e cilësimeve të shpejta për të arritur te **Cilësimet**.
- 2 Prek **Rrjeti dhe interneti > Wi-Fi** dhe pastaj prek **Shto rrjet**.
- 3 Fut emrin e rrjetit dhe çdo informacion të kërkuar rrjeti.
- 4 Prek **LIDHU**.

Kur lidhesh me sukses, telefoni do të lidhet automatikisht herën tjetër që do të jesh brenda rrezes së këtij rrjeti.

Për të harruar një rrjet Wi-Fi

Hapat në vazhdim parandalojnë lidhjet automatike në rrjete që nuk dëshiron t'i përdorësh më.

- 1 Ndiz Wi-Fi, nëse nuk është i ndezur tashmë.
- 2 Në ekranin Wi-Fi, shtyp gjatë emrin e rrjetit të ruajtur.
- 3 Prek **HARRO**.

6.2 Chrome




Duke përdorur shfletuesin Chrome mund të lundrosh në ueb.

Për të hyrë në ueb, shko tek ekranin kryesor dhe prek ikonën Chrome  në shiritin të Preferuara.

Kalimi në një faqe interneti

Në ekranin e shfletuesit Chrome, prek kutinë e URL lart, fut adresën e faqes ueb, pastaj prek  për të konfirmuar.



Prek për të fshirë të gjithë përmbajtjen

Prek për të kërkuar ose për të shkuar në një adresë faqeje ueb

6.3 Lidhja me pajisje me Bluetooth

Bluetooth është një teknologji komunikimi pa tela me diapazon të shkurtër që mund ta përdorësh për të shkëmbyer të dhënat ose për t'u lidhur me pajisje të tjera Bluetooth për përdorime të ndryshme.

Për të hyrë te ky funksion, prek  në shiritin e cilësimeve të shpejta për të arritur te **Cilësimet** pastaj prek **Pajisjet e lidhura > Bluetooth**. Pajisja jote dhe pajisje të tjera të disponueshme do të shfaqen në ekran.

Për të ndezur Bluetooth

1 Prek  në shiritin e cilësimeve të shpejta për të arritur te **Cilësimet**, pastaj prek **Pajisjet e lidhura > Bluetooth**.

2 Prek  për të aktivizuar/çaktivizuar këtë funksion.

Për ta bërë telefonin më të dallueshëm, mund t'i ndryshosh telefonit emrin që u shfaqet të tjerëve.

1 Prek  në shiritin e cilësimeve të shpejta për të arritur te **Cilësimet**.

2 Prek **Pajisjet e lidhura > Bluetooth**.

3 Prek **Emri i pajisjes**.

4 Fut një emër dhe prek **RIEMËRTO** për ta konfirmuar.

Për të çiftuar/lidhur telefonin me një pajisje Bluetooth

Për të shkëmbyer të dhëna me një pajisje tjetër, duhet të ndezësh Bluetooth dhe të çiftosh telefonin me pajisjen Bluetooth me të cilën dëshiron të shkëmbesh të dhëna.

1 Prek  në shiritin e cilësimeve të shpejta për të arritur te **Cilësimet**.

2 Prek **Pajisjet e lidhura > Bluetooth**.

3 **Çifto pajisje të re**.

4 Prek një pajisje Bluetooth në listë me të cilën dëshiron të çiftohesh.

5 Një dialog do të kërcejë, prek **ÇIFTO** për të konfirmuar.

6 Nëse çiftëzimi është i suksesshëm, telefoni lidhet me pajisjen.

Për t'u shkëputur/hequr çiftimin nga një pajisje Bluetooth

1 Prek  pas emrit të pajisjes që dëshiron të heqësh çiftimin.

2 Prek **HARRO**.

6.4 Lidhja me kompjuterin përmes USB-së

Me kabllon USB, mund të transferosh skedarët media dhe skedarë të tjerë mes telefonit dhe kompjuterit.

Për t'u lidhur:

Përdor kabllon USB të ofruar me telefonin për ta lidhur këtë të fundit me folenë USB të kompjuterit. Do të marrësh një njoftim që USB-ja është lidhur.

- Hap panelin Njoftime dhe prek **USB për transferim skedarësh**, pastaj, në dritaren tjetër, zgjidh mënyrën me të cilën dëshiron të transferosh skedarët.

Për të lokalizuar të dhënat e transferuara ose të shkarkuara në hapësirën ruajtëse të brendshme:

1 Prek skedën Aplikacionet nga ekrani kryesor për të hapur listën e aplikacioneve.

2 Prek **Skedarët**.

Të gjitha të dhënat që ke shkarkuar ruhen te **Skedarët**, ku mund të shohësh skedarët media (foto, video, audio dhe të tjera), të riemërtosh skedarët, të instalosh aplikacione në telefon etj.

6.5 Për të hequr pa rrezik kartën microSD nga telefoni

Karta microSD mund të hiqet nga telefoni në çdo moment që telefoni është i fikur. Për të hequr kartën microSD ndërkohë që telefoni është ndezur, duhet të çmontosh fillimisht nga telefonin kartën e hapësirës ruajtëse, për të parandaluar dëmtimin ose prishjen e kartës së hapësirës ruajtëse.

Për të hequr një kartë microSD

1 Prek  në shiritin e cilësimeve të shpejta për të arritur te **Cilësimet**.

2 Prek **Hapësira ruajtëse > Karta SD**.

3 Prek  dhe zgjidh **Cilësimet e hapësirës ruajtëse**.

4 Prek butonin **NXIRR** për ta konfirmuar.

Gjithashtu, thjesht mund të prekësh ikonën  pranë **Kartës SD** për ta nxjerrë atë.

Me secilën nga mënyrat, mund të heqësh në mënyrë të sigurt kartën microSD nga telefoni.

Për të formatuar një kartë microSD

1 Prek  në shiritin e cilësimeve të shpejta për të arritur te **Cilësimet**.

2 Prek **Hapësira ruajtëse > Karta SD**.

3 Prek  dhe zgjidh **Cilësimet e hapësirës ruajtëse > Formato**.

4 Prek  për të konfirmuar.

6.6 Ndarja e lidhjes së të dhënave celulare të telefonit

Lidhjen e të dhënave të celularit mund ta ndash me një kompjuter të vetëm përmes një kablloje USB (shpërndarje interneti me USB) ose me deri në dhjetë pajisje njëherësh duke e kthyer telefonin në pikë hyrëse portative Wi-Fi, ose nëpërmjet Bluetooth.



Ndarja e të dhënave mund të çojë në pagesa shtesë nga operatori i rrjetit. Tarifa shtesë mund të faturohen gjithashtu në zonat roaming.

Të ndash lidhjen e të dhënave të telefonit nëpërmjet USB-së

Përdor kabllon USB që ke marrë me telefonin për të lidhur telefonin me një portë USB në kompjuter.

- 1 Prek  në shiritin e cilësimeve të shpejta për të arritur te **Cilësimet**.
- 2 Prek **Rrjeti dhe interneti > Pika hyrëse dhe shpërndarja e internetit**.
- 3 Prek çelësin  pranë **Lidhja USB** për të aktivizuar/çaktivizuar këtë funksion.

Për të ndarë lidhjen e të dhënave të telefonit nëpërmjet Bluetooth

- 1 Prek  në shiritin e cilësimeve të shpejta për të arritur te **Cilësimet**.
- 2 Prek **Rrjeti dhe interneti > Pika hyrëse dhe shpërndarja e internetit**.
- 3 Prek çelësin  pranë **Lidhjes Bluetooth** për të aktivizuar/çaktivizuar këtë funksion.

Për të ndarë lidhjen e të dhënave të telefonit si pikë shpërndarëse lëvizëse Wi-Fi

- 1 Prek  në shiritin e cilësimeve të shpejta për të arritur te **Cilësimet**.
- 2 Prek **Rrjeti dhe interneti > Pika hyrëse dhe shpërndarja e internetit > Pika hyrëse Wi-Fi**.

3 Prek çelësin  për të aktivizuar/çaktivizuar këtë funksion.

Për të riemërtuar ose siguruar pikën aktive të lëvizshme

Kur një pikë shpërndarëse Wi-Fi është aktivizuar, mund të ndryshosh emrin e rrjetit Wi-Fi të telefonit (SSID) dhe të sigurosh rrjetin e tij Wi-Fi.

1 Prek  në shiritin e cilësimeve të shpejta për të arritur te **Cilësimet**.

2 Prek **Rrjeti dhe interneti > Pika hyrëse dhe shpërndarja e internetit > Pika hyrëse Wi-Fi**.

3 Prek **Konfiguro pikën shpërndarëse Wi-Fi** për të ndryshuar rrjetin SSID ose vendos sigurinë e rrjetit.

4 Prek **RUAJ**.

6.7 Lidhja me rrjete private virtuale

Rrjetet private virtuale (VPN-të) të lejojnë të lidhesh me burime brenda një rrjeti lokal të sigurt nga jashtë atij rrjeti. VPN-të zakonisht shpërndahen nga korporata, shkolla dhe institucione të tjera, kështu përdoruesit e tyre mund të përdorin burimet lokale të rrjetit kur nuk janë brenda atij rrjeti ose kur lidhen me një rrjet me valë.

Për të shtuar një VPN

1 Prek  në shiritin e cilësimeve të shpejta për të arritur te **Cilësimet**.

2 Prek **Rrjeti dhe interneti > VPN** dhe pastaj prek .

3 Në ekranin që hapet, ndiq instruksionet nga administratori i rrjetit për të konfiguruar çdo komponent të cilësimeve VPN.

4 Prek **RUAJ**.

VPN shtohet në listën e ekranit të cilësimeve VPN.



Para se të shtosh një VPN, duhet të vendosësh një motiv kyçjeje të ekranit, kod PIN apo fjalëkalim për telefonin.

Për t'u lidhur/shkëputur me një VPN

Për t'u lidhur me një VPN:

1 Prek  në shiritin e cilësimeve të shpejta për të arritur te **Cilësimet**.

2 Prek **Rrjeti dhe interneti > VPN**.

3 Renditen VPN-të që ke shtuar; prek VPN më të cilën dëshiron të lidhesh.

4 Në dialogun që hapet, fut kredencialet e kërkuara dhe prek **LIDHU**.

Për t'u shkëputur:

- Hap panelin e Njoftimeve dhe prek njoftimin përfundimtar për shkëputjen e VPN-së.

Për të redaktuar/fshirë një VPN

Për të redaktuar një VPN:

1 Prek  në shiritin e cilësimeve të shpejta për të arritur te **Cilësimet**.

2 Prek **Rrjeti dhe interneti > VPN**.

3 Listohen VPN-të që ke shtuar; prek dhe mbaj prekur ikonën  pranë VPN-së që do të modifikosh.

4 Pasi të përfundosh, prek **RUA**.

Për të fshirë:

Prek ikonën  pranë VPN-së së zgjedhur, prek **HARRO** për ta fshirë atë.

7 Google Play Store ⁽¹⁾



Google Play Store është një dyqan programesh online, ku mund të shkarkosh dhe instalosh aplikacione dhe lojëra në telefonin Android.

- Prek skedën e Aplikacionit nga ekrani Kryesor, pastaj prek **Play Store**.
- Herën e parë që hyn te Google **Play Store**, do të shfaqet një ekran me kushtet e shërbimit. Prek **PRANO** për të vazhduar.

Prek ikonën ≡ dhe më pas zgjidh **Ndihma dhe përshtypjet** për të hyrë në faqen e ndihmës së Google Play Store për më shumë informacion mbi këtë funksion.

⁽¹⁾ Në varësi të vendit dhe operatorit.

8 Aplikacione multimediale

8.1 Kamera



Telefoni celular është i pajisur me një Kamera për të bërë fotografi dhe për të xhiruar video.

Para se të përdorësh kamerën, sigurohu që të heqësh lentin mbrojtëse mbuluese para përdorimit për të shmangur ndikimin në cilësinë e fotos.

Për të shkrepur një foto kur telefoni është aktiv, prek ikonën e Kamerës  në shiritin Të preferuara në ekranin kryesor.

Nëse telefoni është i kyçur, shtyp butonin e Energjisë dhe pastaj rrëshqit ikonën kamera në të majtë për të hapur kamerën.



Për të nxjerrë një foto

Ekрани vepron si gjetës pamjeje. Në fillim poziciono objektin ose pamjen në gjetësin e pamjeve, prek ikonën  për të bërë foto e cila do të ruhet automatikisht.

Për të regjistruar një video

Rrëshqit për të ndërruar regjimin e kamerës në **Video** dhe prek pikën e kuqe ● poshtë në qendër të ekranit për të nisur regjistrimin e një videoje.

Prek  për të nxjerrë fotografinë e cila do të ruhet automatikisht.

Prek  për të vendosur në pauzë regjistrimin me video dhe prek  për të vazhduar.

Prek  për të ndaluar regjistrimin. Videoja do të ruhet automatikisht.

8.1.1 Cilësimet e kamerës

Përpara se të shkrepësh një foto/regjistrosh një video, prek ikonën  dhe do të shfaqen për ty opsionet e mëposhtme nga të cilat do të zgjedhësh:

Regjimët



Prek për të hyrë në regjimin **Foto** për shkrepjen e fotove.



Prek për të hyrë në regjimin **Video** për xhirimin e videove.



Hyr në regjimin **Pano**. Prek butonin e shkrepjes që të fillosh të bësh foto panoramike dhe lëviz telefonin në mënyrë të vazhdueshme përgjatë drejtimit të treguar nga linja në ekran. Pasi mbushet korniza e shikimit paraprak, telefoni do të ruajë automatikisht foton.



Të lejon të kontrollosh plotësisht cilësimet e kamerës, duke rregulluar aperturën, diafragmën, ISO dhe më shumë.



Të lejon të krijosh foto panoramike 360-gradëshe mbresëlënëse dhe tërheqëse, që mund t'i ndash në Facebook



Të lejon të krijosh video me shtyrje kohe duke shkrepur një seri fotosh me interval dhe duke i riluajtur me shpejtësi më të lartë.



Të lejon të krijosh një video të shkurtër që mund të shpërndahet lehtë dhe shpejt në rrjetet sociale.



Prek për të modifikuar regjimet e preferuara/të tjera. Regjimet e preferuara mund të qasen me lehtësi duke rrëshqitur horizontalisht në gjetësin e pamjes. Regjimet e tjera mund të qasen nga ekrani i regjimeve.



Prek për të hapur cilësimet e kamerës dhe do të shfaqen opsionet e mëposhtme prej ku mund të zgjedhësh:

Foto

- **Madhësia e fotos (prapa)**

Prek për të zgjedhur madhësinë e fotos.

Video

- **Cilësia e videos (prapa)**

Prek për të zgjedhur HD ose VGA për cilësinë e videos.

- **Kundër tundjes**

Prek për të ndërruar  në kundër tundjes.

Të përgjithshme

- **Redakto regjimet**

Prek për të redaktuar regjimet e kamerës.

- **Rrjetë**

Prek çelësin  për të vendosur/anuluar rrjetën në ekranin e kamerës.

- **Tingulli i shkrepsjes**

Prek çelësin për të aktivizuar/çaktivizuar tingullin e shkrepsjes ndërsa bën foto.

- **Etiketa e vendndodhjes**

Prek çelësin për të aktivizuar/çaktivizuar funksionin e etiketës së vendndodhjes.

- **Kontrolli i tasteve të volumit**

Prek për të zgjedhur nga Shkrepësi, Zmadhimi dhe Joaktiv.

- **Nisja e shpejtë e kamerës**

Prek çelësin  për të aktivizuar/çaktivizuar nisjen e shpejtë të kamerës duke shtypur dy herë tastin e volumit kur ndodhet në ekranin e fjetjes ose të kyçjes.

- **Hapësira ruajtëse**

Prek për të zgjedhur Telefonin ose kartën SD për ruajtjen e fotove/videove.

- **Zmadho**

Prek çelësin  për të aktivizuar/çaktivizuar funksionin e zmadhimit.

- **Rivendosja në cilësimet e fabrikës**


Prek për të rikthyer Kamerën në cilësimet e fabrikës.

8.2 Galeria



Fotot vepron si një aparat media për të shfaqur fotot dhe për të luajtur videot.


Për të hapur fotot, prek shiritin e aplikacioneve nga ekrani kryesor, pastaj prek **Galeria**.



Rrëshqit lart ose poshtë për të shfaqur më shumë albume

Për të parë një foto/për të luajtur një video

Fotot dhe videot shfaqen nga albumet te **Galeria**.



Prek që të kthehesh në ekranin kryesor të galerisë

Rrëshqit lart ose poshtë për të shfaqur më shumë foto


- Prek një album dhe të gjitha fotot apo videot do të shfaqen në ekran.
- Prek foton/videon direkt për ta parë ose luajtur atë.
- Rrëshqit lart/poshtë për të parë foton/videon tjetër ose të mëparshme.

Redaktimi i fotografive

Mund të redaktosh fotografitë, mund të shtosh efekte, të presësh, ndash dhe t'i vendosësh ato si fotografi kontakti ose si sfonde.

Përzgjidh fotografinë me të cilën dëshiron të punosh dhe prek opsionet e disponueshme të tilla si redaktimi, ndarja, prerja ose fshirja. Prek **:** për më shumë opsione.

← ⋮ — Prek për të hapur opsionet e disponueshme.



Prek që të ndash foton
nëpërmjet aplikacioneve të
zgjedhura

Prek për të modifikuar fotografinë.

Prek për të shtuar foton te të
preferuarat.

Prek për të fshirë foto



Prek  në pamjen me ekranit të plotë për të modifikuar foton.



 Prek për të shtuar efekte si "Original, Auto, Perëndim"
etj.

 Prek për të shtuar kontur.



Prek për të **prerë, drejtuar, rrotulluar, pasqyruar** ose **vizatu**ar foton.



Prek për të rregulluar cilësimet e fotos, si "Ekspozimi, Vinjetë" etj.



Pas aktivizimit të regjimit të prerjes, katërkëndëshi prerës paraqitet në mes të fotografisë. Zgjidh pjesën për t'u prerë, prek  për ta konfirmuar dhe **Ruaj** ose prek ikonën  për ta anuluar.

8.3 Luaj muzikë




Mund të luash skedarë muzike të ruajtur në kartën microSD në telefon. Skedarët muzikorë mund të shkarkohen nga kompjuteri në kartën microSD duke përdorur një kabllo USB.

Për të luajtur muzikë, prek butonin e Aplikacionit nga ekrani Kryesor, pastaj prek **Luaj muzikë**.

Do të gjesh katër kategori në të cilat gjithë këngët janë klasifikuar: **LISTAT E KËNGËVE, ARTISTËT, ALBUMET, KËNGËT** dhe **ZHANRET**. Rrëshqit majtas dhe djathtas për t'i parë të gjitha ato. Prek **PËRZIEJ TË GJITHA** për të riluajtur të gjitha këngët.

8.3.1 Për të luajtur muzikë

Prek një këngë për ta luajtur atë.



Prek për të kërkuar muzikë

Prek për të zgjedhur **Dëgjo tani** ose **Biblioteka muzikore**

Prek që të luash listën aktuale në regjim të përzierë (këngët luhen në mënyrë të rastësishme)

Prek për të ndaluar/
rinisur ridëgjimin

Prek tastin  për të hapur **Cilësimet**

LLOGARIA

Prek për të zgjedhur një llogari.

LUAJTJA

Balancuesi

Prek për të rregulluar cilësimet audio.

Lejimi i pajisjeve të jashtme të fillojnë luajtjen

Prek çelësin  për t'u lejuar pajisjeve të jashtme të fillojnë luajtjen, si p.sh. Bluetooth veture, kufje me tel etj.

Shfaqja e kopertinave të albumeve në ekranin e kyçur

Prek çelësin  për të aktivizuar shfaqjen e kopertinave të albumeve në ekranin e kyçur.

RRETH LUAJTJES SË MUZIKËS

Politika e privatësisë

Prek për të lexuar politikën e privatësisë me aplikacionin.



Ndërsa luan këngët te muzika, mund t'u bësh pauzë, t'i luash apo kapërcesh edhe nëse ekrani është i kyçur.

Prek ⓘ kur një këngë është e theksuar për opsionin në vijim:

Luaj më pas

Prek që të luash këngën tjetër që zgjodhe.

Shto te radha

Prek për të shtuar këngën në radhën e atyre që luhen tani.

Shto në listën e luajtjes

Prek për të shtuar në një listë luajtjeje.

Shko te artisti

Prek që të shkosh te artisti.

Shko te albumi

Prek që të shkosh te album.

Fshi

Prek që të fshish këngën.

9 Hartat



9.1 Gjej vendndodhjen time

9.1.1 Aktivizo GPS

Për të aktivizuar marrësin satelitor të sistemit të pozicionimit global të telefonit (GPS):

- 1 Prek  në shiritin e cilësimeve të shpejta për të arritur te **Cilësimet**.
- 2 Prek **Siguria dhe vendndodhja > Vendndodhja**.
- 3 Prek çelësin pranë **Vendndodhjes** dhe zgjidh regjimin e vendndodhjes që preferon.

9.1.2 Hap Maps Go dhe shfaq "Vendndodhja ime"

Prek skedën Aplikacionet në ekranin kryesor dhe zgjidh **Hartat**.

Prek ikonën  në hartë për të parë **Vendndodhja ime**.

Harta do të qendërzohet në një pikë blu. Pozicioni yt aktual do të jetë te pika blu.




Për të lëvizur hartën, zvarrit hartën me gisht.

Për të zmadhuar apo zvogëluar në hartë, bashkoji ose hapi gishtat e tu, ose gjithashtu mund të zmadhosh duke klikuar dy herë një vendndodhje në ekran.

9.2 Kërko për një vendndodhje

Në kutinë e kërkimit, fut një adresë, një qytet ose një biznes lokal. Prek ikonën e kërkimit për të kërkuar dhe pas pak rezultatet e kërkimit do të shfaqen në hartë si pika të kuqe. Mund të prekësh njërën për të treguar një emërtim.



Zvarrit lart për të parë më shumë rezultate kërkimi

9.3 Ruaj një vendndodhje

Ashtu siç vendos faqeshënues për një adresë ueb në internet, mund të vendosësh faqeshënues për çdo pozicion në hartë për përdorim të mëvonshëm. Mjafton të prekësh ikonën lëshuese të kuqe  për të hapur një meny rreth vendndodhjes, pastaj prek ikonën RUAJ  për ta ruajtur atë.

Nëse nuk ka ikonë në pikën që dëshiron të ruash, shtyp dhe mbaj në atë vendndodhje në ekran për të krijuar një të tillë.


9.4 Hap Street View për një vendndodhje

- 1 Shtyp gjatë një vendndodhje për të shfaqur adresën e saj në pjesën e poshtme të ekranit të hartës.
- 2 Zvarrit lart detajet e ekranit për t'i ruajtur kur s'je në linjë.

9.5 Merr drejtime për drejtim mjeti, transport ose drejtime për ecje

9.5.1 Merr itinerare të sugjeruara për udhëtimin

Prek ikonën  në ekranin e hartave.



- 1 Prek shiritin fut për të edituar pikën e fillimit duke futur një adresë ose duke zgjedhur një artikull të ruajtur.
- 2 Vepro kështu për pikën e fundit.
- 3 Për të kthyer mbrapsht drejtimin, prek .
- 4 Pastaj zgjidh një mënyrë transporti: me makinë, përdorur transportin publik ose ecje në këmbë.
- 5 Prek **Opsionet e itinerarit** për të zgjedhur **Shmang autostradat**, **Shmang rrugët me pagesë** ose **Shmang tragetet**.
- 6 Disa itinerare të sugjeruara do të shfaqen në një listë. Prek secilin nga itineraret të shiko detajet përkatëse të drejtimit.

10 Të tjerat

10.1 Skedarët



Për të hapur këtë funksion, prek skedën e aplikacionit nga ekrani kryesor dhe pastaj prek **Skedarët**.

Skedarët punon si me kartë microSD, ashtu dhe me hapësirën ruajtëse të telefonit.

Skedarët shfaq të gjitha të dhënat e ruajtura si në kartën microSD, ashtu dhe në hapësirën ruajtëse të telefonit, duke përfshirë aplikacionet, skedarët media; videot, fotot ose audiot që ke regjistruar; të dhëna të tjera të transferuara nëpërmjet Bluetooth, kabllos USB etj.

Kur shkarkon një aplikacion nga kompjuteri te karta microSD, mund ta spikatësh aplikacionin në Skedarët, pastaj preke për ta instaluar në telefon.

Skedarët të lejon të kryesh dhe te jesh me të vërtetë efikas me veprimet e zakonshme të mëposhtme: krijo (nën) dosje, hap dosje/skedë, shiko, riemëro, prit, kopjo, fshij, luaj, ndaj etj.

10.2 Regjistruesi i zërit



Për të regjistruar një tingull ose memo zanore, prek butonin e Aplikacionit nga ekrani Kryesor, pastaj prek **Regjistrim tingulli**.

10.3 Radio




Telefoni është i pajisur me një radio ⁽¹⁾. Mund ta përdorësh këtë aplikacion si një radio tradicionale me kanale të ruajtura ose me informacione vizuale paralele të lidhura me programin e radios në ekran nëse e sintonizon në stacione që ofrojnë shërbim Visual Radio.

Për të dëgjuar radion, prek butonin e aplikacionit nga ekrani kryesor, pastaj prek **Radio**.

⁽¹⁾ Cilësia e radios varet nga mbulimi me valë i stacionit të radios në atë zonë të caktuar.

Fut një kufje për të dëgjuar radion. Kufja përdoret si një antenë për radion.



Prek për të shtuar stacionin aktual te të preferuarat ose për ta hequr atë nga të preferuarat.

Prek për të shkuar në kanalin e mëparshëm

Prek për të zvogëluar me 0,1 MHz
Prek gjatë për të kërkuar dhe për të shkuar te kanali më i afërt i frekuencave të ulëta

Prek për të rritur me 0,1 MHz

Prek për të shkuar në kanalin tjetër

Opsionet e mundshme:

- **Ruaj kanalin**

Ruaj kanalin.

- **Skano kanalet**

Skano të gjitha kanalet.

- **Fshi**

Fshi kanalin.

- **Fut frekuencën**

Fut frekuencën në mënyrë manuale.

- **Informacioni i kanalit**

Shëno kutinë e kontrollit për të shfaqur informacionin e stacionit.

- **Dil**

Fike radion dhe dil nga aplikacioni radio.

11 Cilësimet



Zvarrit dy herë poshtë nga paneli i Njoftimeve dhe prek ikonën Cilësimet  për të hapur **Cilësimet**.

11.1 Rrjeti dhe interneti

11.1.1 Wi-Fi

Duke përdorur Wi-Fi mund të navigosh në Internet pa përdorur kartën SIM kurdo që je në një zonë rrjeti me valë. E vetmja gjë që duhet të bësh është fusësh ekranin **Wi-Fi** dhe konfigurosh një pikë hyrjeje për të lidhur telefonin tënd me rrjetin me valë.

Për instruksione të detajuara në përdorimin e Wi-Fi, referohu te "6.1.2 Wi-Fi".

11.1.2 Rrjetet celulare

- **Roaming i të dhënave**

Prek çelësin për t'u lidhur me shërbimet e të dhënave kur je në roaming.

- **Kujtesë për roaming-un e të dhënave**

Prek çelësin për të lejuar/refuzuar pyetjen përpara lidhjes së të dhënave kur telefoni është i ndezur.

- **Lloji i preferuar i rrjetit**

Prek për të zgjedhur llojin e rrjetit të preferuar.

- **Emrat e pikës së hyrjes**

Mund të zgjedhësh rrjetin e preferuar me këtë meny.

- **Operatorët e rrjetit**

Mund të zgjedhësh një operator rrjeti.

- **Emri i operatorit të rrjetit**

Prek për të ndërruar lejimin/refuzimin e shfaqjes së emrit të operatorit të rrjetit në shiritin e statusit.

11.1.3 Përdorimi i të dhënave

Për të aktivizuar/çaktivizuar të dhënat celulare duke prekur çelësin .

Prek çelësin **Cikli i faturimit** dhe më pas **Vendos kufirin e të dhënave**, më pas prek **Kufiri i të dhënave** për të konfiguruar maksimumin e të dhënave celulare që dëshiron të përdorësh. Lidhja e të dhënave të lëvizshme do të jetë e pamundur kur limiti i specifikuar të jetë arritur. Gjithashtu mund të zgjedhësh një cikël përdorimi të dhënash për të parë statistikën dhe aplikacione të lidhura me të dhëna të përdorura nga telefoni.

Prek ikonën  dhe mund të shfaqësh më shumë cilësime lidhur me përdorimin e të dhënave.



Përdorimi i të dhënave matet nga telefoni dhe operatori mund ta llogarisë ndryshe.

11.1.4 Pika hyrëse dhe shpërndarja e internetit

Ky funksion të lejon të shpërndash lidhjen e të dhënave celulare të telefonit nëpërmjet USB-së ose si pikë hyrëse portative Wi-Fi (shih "**6.6 Ndarja e lidhjes së të dhënave celulare të telefonit**")

Gjithashtu mund të zgjedhësh regjimin e Fluturimit në opsionet e telefonit kur të shtypësh tastin e **Energjisë**.

11.1.5 VPN

Një rrjet virtual privat celular (VPN ose mVPN celulare) u siguron celularëve qasje në burimet e rrjetit dhe aplikacionet softuerë në rrjetin e tyre kryesor, kur ato lidhen nëpërmjet një tjetër rrjeti me valë ose me tela. VPN celulare përdoren në mjedise ku punonjësit kanë nevojë të mbajnë sesionet e aplikacioneve të tyre hapur gjithë kohës, gjatë ditës së punës, ndërkohë që përdoruesi lidhet nëpërmjet rrjeteve të ndryshme pa tela, has boshllëqe në mbulim ose pezullon dhe rinis telefonat e tij për të ruajtur jetën e baterisë. Një VPN konvencionale nuk mund t'u mbijetojë ngjarjeve të tilla sepse tuneli i rrjetit ndërpritet, duke bërë që aplikacionet të shkëputen, vonohen, dështojnë, madje edhe vetë pajisja kompjuterike të mos punojë.

Për më shumë informacion rreth VPN, shih "**6.7 Lidhja me rrjete private virtuale**".

11.1.6 Regjimi i fluturimit

Përdor **Regjimi i fluturimit** për të çaktivizuar njëherësh të gjitha lidhjet me valë, duke përfshirë Wi-Fi, Bluetooth dhe të tjera.

Gjithashtu mund të zgjedhësh regjimin e Fluturimit në opsionet e telefonit kur të shtypësh tastin e **Energjisë**.

11.1.7 Telefonimi përmes Wi-Fi

Prek çelësin  për të aktivizuar/çaktivizuar **Thirrjen Wi-Fi**.

11.2 Pajisjet e lidhura

11.2.1 Bluetooth

Bluetooth lejon telefonin që të shkëmbejë të dhëna (video, imazhe, muzikë, etj.) në një zonë të vogël me një tjetër aparat që mbështet Bluetooth (telefon, kompjuter, printer, kufje, set makine, etj.).

Për më shumë informacion rreth Bluetooth, shih "**6.3 Lidhja me pajisje me Bluetooth**".

11.2.2 Transmeto

Prek për të caktuar shfaqjen nëpërmjet lidhjes me valë.

11.2.3 NFC

Prek çelësin  për të lejuar/refuzuar shkëmbimin e të dhënave kur telefoni prek një pajisje tjetër.

11.2.4 Android Beam

Trokit Android Beam, prek çelësin  për të aktivizuar/çaktivizuar Android Beam.

Kur kjo veçori aktivizohet, mund të transmetosh përmbajtjen e aplikacionit te një pajisje tjetër me kapacitet për NFC duke mbajtur pajisjet bashkë. Për shembull, mund të transmetosh faqe Shfletuesi, video YouTube, Kontaktet, etj.

Mjafton t'i bashkosh pajisjes bashkë (zakonisht me kurriz) dhe më pas trokit ekranin. Aplikacioni përcakton se çfarë transmetohet.

11.2.5 Printimi

Telefoni mbështet printimin me valë në printerë dhe shërbime në internet të aktivizuara.

11.2.6 USB

Prek për të parë aplikacionet me parazgjedhje të instaluara në telefon.

Me kabllon USB, mund të transferosh skedarët media dhe skedarë të tjerë mes telefonit dhe kompjuterit. Për më shumë informacion rreth USB, shih **"6.4 Lidhja me kompjuterin përmes USB-së"**.

11.3 Aplikacionet dhe njoftimet

Cilësimet e aplikacioneve i përdor për të shfaqur detajet në lidhje me aplikacionet e instaluara në telefon, për të menaxhuar të dhënat e tyre dhe për t'i detyruar ato të ndalojnë dhe për të vendosur nëse dëshiron të lejosh instalimin e aplikacioneve që merr nga faqet e internetit dhe emailt. Mund të marrësh dhe cilësime të mëtejshme për njoftimet e aplikacioneve ose të sistemit.

11.4 Bateria

Në ekranin e Baterisë mund të shfaqësh të dhënat e përdorimit të baterisë që në momentin e fundit që ke lidhur telefonin me një burim energjie. Ekranin gjithashtu tregon statusin e baterisë dhe sa gjatë është përdorur ajo që nga karikimi i fundit. Prek një kategori për të gjetur konsumin e saj specifik të energjisë.

Mund të rregullosh përdorimin e energjisë nëpërmjet dritës së ekranit ose vonesës së ekranit në pamjen Ekranin.

11.5 Ekran

Ekran kryesor

Prek për të caktuar stilin e ekranit kryesor.

Paneli i aplikacioneve të preferuara

Prek për të aktivizuar funksionin e nisjes së aplikacionit të preferuar duke rrëshqitur djathtas.

Aplikacioni i preferuar i Ekranit kryesor

Prek për të zgjedhur aplikacionin që preferon të hapet kur rrëshqet djathtas.

Kyç strukturën e ekranit kryesor

Prek çelësin për të aktivizuar funksionin e kyçjes së strukturës së ekranit kryesor.

Butonat e navigimit

Zvarrit një ikonë për të riorganizuar butonat e navigimit.

Shkurtoret e ekranit të kyçjes

Prek për të aktivizuar funksionet e aksesit të shpejtë në ekranin e kyçjes.

Regjimi i ekranit

Prek për të vendosur regjimin e ekranit.

Niveli i ndriçimit

Prek që të rregullosh shkëlqimin e ekranit.

Drita e natës

Prek për të caktuar dritën e natës.

Aplikacionet në ekran të plotë

Prek për të zgjedhur cilat aplikacione dëshiron të përdorësh në ekran të plotë.

Ndriçimi me përshtatje

Prek për të aktivizuar funksionin e optimizimit të nivelit të ndriçimit për dritën e disponueshme.

Sfondi

Prek për të vendosur sfond.

Fjetja

Prek për të vendosur fikjen e ekranit.

Dritën e njoftimeve me pulsimit

Prek çelësin për të aktivizuar/çaktivizuar dritën e njoftimeve me pulsimit.

Rrotullimi automatik i ekranit

Prek çelësin për të aktivizuar/çaktivizuar funksionin e rrotullimit automatik të ekranit.

Madhësia e fontit

Prek për të vendosur madhësinë e fontit.

Madhësia e shfaqjes

Prek për të vendosur madhësinë e shfaqjes.

Ruajtësi i ekranit

Prek për të vendosur ruajtësin e ekranit.

11.6 Tingulli

Përdor cilësimet e Tingullit për të konfiguruar zilet për ngjarje dhe mjedise të ndryshme.

Volumi i ziles

Rrëshqit për të rregulluar volumin e melodive.

Volumi i medias

Rrëshqit për të rregulluar volumin e muzikës, videos, lojërave, etj.

Volumi i njoftimit

Rrëshqit për të rregulluar volumin e njoftimeve.

Volumi i alarmit

Rrëshqit për të rregulluar volumin e alarmeve.

Edhe dridhje për thirrje

Prek për vibrim të telefonit për thirrjet hyrëse.

Preferencat e regjimit "Mos shqetëso"

Prek për të zgjedhur aplikacionet prioritare për lejim të njoftimeve ose personalizoj rregullat automatike.

Çelësi i regjimit të heshtjes

Prek çelësin për të aktivizuar/çaktivizuar bllokimin e të gjithë tingujve dhe dridhjeve nga ekrani i kyçur.

Aktivizo çelësin e heshtjes për

Prek çelësin e heshtjes për të **Lejuar vetëm alarmet** ose për **Heshtje të plotë**.

Zilja e telefonit

Prek për të vendosur zilen e paracaktuar të thirrjes hyrëse.

Zëri i parazgjedhur i njoftimit

Prek për të caktuar zërin e parazgjedhur të njoftimit.

Tingulli i alarmit i paracaktuar

Prek për të caktuar tingullin e alarmit të paracaktuar.

Tinguj dhe dridhje të tjera

Prek për të caktuar tingujt e tastierës, tingujt e kyçjes së ekranit, tingujt e prekjes dhe dridhjen në prekje.

11.7 Hapësira ruajtëse

Përdori këto cilësime për të monitoruar hapësirën e përgjithshme dhe të disponueshme në telefon dhe në kartën microSD; për të menaxhuar kartën microSD; dhe, nëse është e nevojshme, për të rivendosur telefonin, duke fshirë të gjitha të dhënat e tua personale.

Hapësira ruajtëse e brendshme e përbashkët

Kjo meny shfaq sasinë e kujtesës së brendshme të telefonit. Kujtesa e përdorur do të shfaqet në jeshile, që tregon sasinë e kujtesës së brendshme të telefonit të përdorur nga sistemi i operimit, komponentët e tij, aplikacionet (duke përfshirë ata që ke shkarkuar), të dhënat e përhershme dhe të përkohshme.

11.8 Siguria dhe vendndodhja

Google Play Protect

Kontrollo aplikacionet dhe telefonin për veprimtari të dëmshme.

Gjej pajisjen time

Prek çelësin për të aktivizuar/çaktivizuar gjetjen e telefonit.

Përditësimi i sigurisë

Prek për të kontrolluar versionin aktual të sistemit dhe kontrollo për përditësimin e sistemit.

Kyçja e ekranit

- **Asnjë**

Prek për të çaktivizuar sigurinë e kyçjes së ekranit.

- **Rrëshqit**

Prek që të mundësosh regjimin shkyçjeje ekrani.

- **Motivi**

Prek që të vizatosh motiv për të shkyçur ekranin.

- **PIN**

Prek që të futësh një PIN numerik për të shkyçur ekranin.

- **Fjalëkalimi**

Prek që të futësh një fjalëkalim për të shkyçur ekranin.

Preferencat e ekranit të kyçjes

Prek për të zgjedhur preferencat e ekranit të kyçjes.

Kyçja inteligjente

Duhet të vendosësh fillimisht një kyçje ekrani kur aktivizon këtë funksion.

Vendndodhja

Regjimi

Zgjidh një regjim për qasjen e vendndodhjes.

- **Saktësi e lartë**

Përdor GPS, Wi-Fi, Bluetooth ose rrjetet celulare për të përcaktuar vendndodhjen.

- **Ruajtja e baterisë**

Përdor Wi-Fi, Bluetooth ose rrjetet celulare për të përcaktuar vendndodhjen.

- **Vetëm pajisja**

Përdor GPS për të përcaktuar vendndodhjen tënde.

Lejet në nivel aplikacioni

Prek për të caktuar lejet e vendndodhjes për aplikacionet.

Skanimi

Përmirëso vendndodhjen duke lejuar aplikacionet dhe shërbimet e sistemit të diktojnë në çdo kohë rrjetet Wi-Fi dhe pajisjet me Bluetooth.

Kërkesë e fundit për vendndodhjen

Shqyrto kërkesat e fundit për vendndodhjen.

Shërbimet e vendndodhjes

Shqyrto shërbimet e vendndodhjes për Google.

Shfaq fjalëkalimet

Prek çelësin për të shfaqur fjalëkalimet ndërsa i shkruan.

Aplikacionet e administratorit të pajisjes

Prek për të parë ose çaktivizuar administratorët e telefonit.

Kyçja e kartës SIM

Zgjidh një kartë SIM që dëshiron të konfigurosh.

Ndërro ikonën  në krah të kyçjes së kartës SIM, për ta kyçur kartën SIM me kod PIN.

Prek ndryshimin e kodit PIN të kartës SIM, për të ndryshuar kodin PIN.

Enkriptimi dhe kredencialet

- **Enkripto telefonin**

Shiko nëse telefoni është i enkriptuar.

- **Lloji i hapësirës ruajtëse**

Shfaq tipin e hapësirës ruajtëse të telefonit tënd.

- **Kredenciale të besuara**

Prek për të shfaqur certifikatat e besuara CA.

- **Kredencialet e përdoruesit**

Prek për të parë dhe modifikuar kredencialet e ruajtura.

- **Instalo nga karta SD**

Prek për të instaluar certifikata të enkriptuara nga karta SD.

- **Pastro kredencialet**

Prek për të hequr të gjithë kredencialet.

Agjentët e besuar

Prek për të shfaqur ose për të çaktivizuar agjentët e besuar.

Gozhdimi i ekranit

Prek për të vendosur gozhdimin e ekranit.

Aplikacione me qasje në përdorim

Prek për të caktuar autorizimin e përdorimit për aplikacionet.

11.9 Kufizimet prindërore

Ky celular inteligjent vjen me funksione të integruara bazë për kontrollin prindëror, duke të lejuar për shembull të kufizosh apo çaktivizosh hyrjen në dyqanin e aplikacioneve dhe lojëra. Mund të caktosh kufij për përdorimin e aplikacioneve si edhe mund të lokalizosh me lehtësi telefonin dhe përdoruesin përmes uebsajtit të aplikacionit të Menaxherit të pajisjes të Google.

Prek **Kufizimet prindërore** nga ekrani i telefonit **Cilësimet**. Një asistent do të të udhëzojë gjatë hapave për të konfiguruar informacionin e kontrollit prindëror.

1. Prek **NIS KONFIGURIMIN**. Jep një fjalëkalim 6-shifror për kufizimet prindërore. Prek **TJETËR**.
2. Fut fjalëkalimin sërish dhe më pas prek **TJETËR**.
3. Fut emrin tënd (ose si kujdestar) dhe numrin e telefonit si kontakt urgjence dhe për të marrë kodin PIN në rast se e harron. Prek **TJETËR**.
4. Fut numrin e verifikimit PIN të dërguar te numri i kontaktit. Prek **VERIFIKO**.
5. Prek **Kontrolli i autorizimeve të pajisjes**.
Prek  për të hapur kufizimet dhe për të caktuar një orar kur mund të përdoret telefoni. Nëse është jashtë orareve të planifikuara, telefoni kyçet automatikisht.
6. Prek **Kontrolli i qasjes në aplikacione**.
7. Zgjidh aplikacionin ku dëshiron të shtosh kontrollin e qasjes ose cakto limitin kohor për qasjen.
8. Prek  për të aktivizuar kufizimin.
9. Prek ditët dhe zgjidh opsionet e periudhës për të caktuar afatin.

Operacionet e mëtejshme

Cilësimet e kyçjes së pajisjes

Prek çelësin për të aktivizuar kyçjen e cilësimeve të telefonit, në mënyrë që të nevojitet një kod PIN për të hyrë te cilësimet herën tjetër.

Kyçja e ekranit kryesor

Prek çelësin për të parandaluar shtimin/modifikimin/fshirjen e miniaplikacioneve dhe të aplikacioneve në ekranin kryesor.

Çaktivizo instalimin/çinstalimin e aplikacioneve

Prek çelësin për të çaktivizuar instalimin/çinstalimin e aplikacioneve.

Shfaq kontaktin e urgjencës

Prek çelësin për të aktivizuar shfaqjen e numrit të kontaktit të kujdestarit në ekranin e kyçjes.

Detyro zilen

Prek çelësin për të aktivizuar zilen e thirrjeve hyrëse në volum maksimal.

10. Prek **CAKTO TË GJITHA** për të caktuar të gjitha kufizimet prindërore.

11.10 Përdoruesit dhe llogaritë

Mund të përdorësh cilësimet për të shtuar, hequr dhe menaxhuar emailin dhe llogari të tjera të mbështetura. Gjithashtu mund të përdorësh këto cilësime për të kontrolluar si dhe nëse të gjitha aplikacionet dërgojnë, marrin dhe sinkronizojnë të dhënat në programet e tyre dhe nëse të gjitha aplikacionet mund të sinkronizojnë automatikisht të dhënat e përdoruesve të tyre.

Shto llogari

Prek që të shtosh një llogari për aplikacionin e zgjedhur.

Informacioni i urgjencës

Prek për të vendosur informacionin e urgjencës.

Regjimi i urgjencës

Prek për të caktuar regjimin e urgjencës

Sinkronizoji të dhënat automatikisht

Prek çelësin për të aktivizuar rifreskimin automatik të të dhënave.

11.11 Qasja

Mund të përdorësh cilësimet e Qasjes për të konfiguruar çdo shtojcë qasjeje që ke instaluar në telefon.

Këshillat e ndihmës

Prek çelësin për të aktivizuar/çaktivizuar këshillat ndihmëse.

Shkurtesa e tastit të volumit

Prek për të hapur cilësimet e shkurtesave për tastin e volumin.

Zgjidh për të folur

Prek për të çaktivizuar/dëgjuar tekstin e zgjedhur.

Ndryshimi i qasjes

Prek për të aktivizuar/çaktivizuar ndryshimin e qasjes.

TalkBack

Prek që të aktivizuar/çaktivizuar TalkBack. Me Talkback të aktivizuar, telefoni ofron reagim folës për të ndihmuar përdoruesit e verbër dhe ata me shikim të dobët nëpërmjet përshkrimit çfarë prek, zgjedh dhe aktivizon.

Për të dalë nga TalkBack, prek çelësin e aktivizimit dhe në çelës do të fokusohet një kornizë katrore. Më pas trokit dy herë çelësin me shpejtësi derisa të shfaqet një mesazh për të pyetur nëse dëshiron të ndalohet Talkback. Prek OK dhe një kornizë katrore do të fokusohet mbi ikonë. Më pas trokit dy herë te OK me shpejtësi për të çaktivizuar TalkBack.

Konvertimi i tekstit në të folur

Referoju më parë cilësimit "Motori i preferuar/Shpejtësia e të folurës/Niveli/Dëgjo një shembull/Statusi i gjuhës së paracaktuar".

Madhësia e fontit

Prek për të caktuar dhe për ta bërë tekstin në ekran më të vogël ose më të madh.

Madhësia e shfaqjes

Prek për të vendosur dhe për t'i bërë artikujt në ekran më të vegjël ose më të mëdhenj.

Zmadhim

Prek që të ndezësh/fikësh për të aktivizuar/çaktivizuar funksionin zmadhim/zvogëlim duke shtypur trefish në ekran.

Korrigjimi i ngjyrave

Prek për të aktivizuar/çaktivizuar korrigjimin e ngjyrave

Përmbysja e ngjyrave

Prek çelësin për të aktivizuar përmbysjen e ngjyrave.

Kursor i madh i mouse-it

Prek çelësin për të aktivizuar/çaktivizuar kursorin e madh të mouse-it.

Kliko pasi kursori ndalon së lëvizuri

Prek, më pas ndërro ikonën , për të aktivizuar/çaktivizuar klikimin pasi kursori të ndalojë lëvizjen.

Butoni i ndezjes mbyll thirrjen

Prek çelësin për të aktivizuar/çaktivizuar Butoni i ndezjes mbyll thirrjen.

Rrotullimi automatik i ekranit

Prek çelësin për të aktivizuar/çaktivizuar rrotullimin automatik të ekranit.

Vonesa e prekjes dhe mbajtjes

Prek që të rregullosh kohëzgjatjen e vonesës së prekjes dhe mbajtjes. Ky funksion mundëson telefonin që të vendosë se sa kohë duhet për të mbajtur prekjen para se të regjistrohet.

Audio mono

Prek çelësin për të lejuar/refuzuar kombinimin e kanaleve kur luhet audio.

Titrat

Prek për të aktivizuar/çaktivizuar titrat për ekranin e telefonit.

Tekst me kontrast të lartë

Prek çelësin për të aktivizuar/çaktivizuar tekstin me kontrast të lartë.

Ndezja dhe fikja e programuar

Prek për të caktuar ndezjen/fikjen automatike të telefonit.

11.12 Google

Ky telefon ofron llogari Google dhe opsionet e cilësimeve të shërbimeve.

11.13 Sistemi

11.13.1 Gjuhët dhe hyrja

Përdor cilësimet Gjuha dhe futja e të dhënave për të zgjedhur gjuhën për tekstin në telefon dhe për konfigurim të tastierës virtuale. Gjithashtu mund të konfigurosh cilësime të futjes së zërit dhe të shpejtësisë së treguesit.

Gjuhët

Prek që të zgjedhësh gjuhën dhe rajonin që dëshiron.

Tastiera virtuale

• Gboard Go

Gjuhët

Prek për të vendosur gjuhën dhe mënyrën e hyrjes.

Preferencat

Prek për të përzgjedhur preferencën e shkrimit, si Regjimi me një dorë, Stilet e personalizuara të hyrjes, Shtyp gjatë për simbolet, Lartësia e tastierës, etj.

Tema

Prek për të zgjedhur temën e tastierës dhe të modifikosh stilet e hyrjes që preferon.

Korrigjimi i tekstit

Prek për të shfaqur opsionet e ndryshme që synojnë të lehtësojnë organizimin e tekstit, të tilla si korrigjimi automatik të cilat mund të korrigjojnë fjalët e shtypura gabim automatikisht, shfaqin sugjerime korrektuese të cilat mund të shfaqin fjalët e sugjeruara ndërkohë që shtyp, etj.

Shkrimi me rrëshqitje

Prek për të konfiguruar shkrimin me rrëshqitje, si p.sh. shkrimi me rrëshqitje, shfaqja e gjurmës së rrëshqitjes etj.

Shkrimi me zë

Prek për të konfiguruar shkrimin me zë, si p.sh. Gjuhët, Shfaq/Bloko fjalët ofenduese etj.

Fjalori

Prek për të parë cilësimet e Fjalorit personal.

Kërko

Prek për të hapur cilësimet e kërkimit.

Të avancuara

Prek për të parë cilësime më të përparuara për Tastierën e Google, të tilla si Emoji për tastierën fizike, Shfaq ikonën e aplikacionit, Ndaj statistikën e përdorimit, Ndaj copëza informacioni, etj.

• Shtypja me zë e Google

Prek për të konfiguruar cilësimet për shtypjen me zë të Google.

• Menaxho tastierat

Prek  për të menaxhuar tastierat.

Tastiera fizike

Prek për më shumë ndihmë për tastierën.

Kontrolli drejtshkrimor

Prek për të hapur cilësimin e korigjuesit drejtshkrimor.

Shërbimi i plotësimit automatik

Prek për të caktuar shërbimin e plotësimit automatik.

Fjalori personal

Prek për të shtuar fjalë si fjalorin tënd të posaçëm.

Shpejtësia e kursorit

Prek për të hapur një dialog ku mund të ndryshosh shpejtësinë e kursorit, prek **OK** për të konfirmuar.

Konvertimi i tekstit në të folur

Prek për të konfiguruar cilësimet për shtypjen me zë të Google.

• Motori i preferuar

Prek për të zgjedhur një mjet të preferuar të konvertimit nga teksti në të folur, prek ikonën Cilësimet  për të shfaqur më shumë alternativa për çdo motor.

- **Gjuha**

Prek për të zgjedhur gjuhët për tekst-ligjërimit.

- **Shpejtësia e të folurit**

Rrëshqit për të vendosur se sa shpejt dëshiron që të flasë sintetizatori.

- **Niveli**

Rrëshqit për të vendosur nivelin që dëshiron që të flasë sintetizatori.

Prek ikonën  për të luajtur një fragment nga instrumenti i ligjërimit, duke përdorur cilësimet e tua aktuale.

Prek ikonën  për t'i rivendosur shpejtësinë ose lartësinë në të cilat flitet teksti në normale ose bazë.

11.13.2 Data dhe ora

Përdor cilësimet e Datës dhe orës për të personalizuar preferencat se si shfaqet data dhe ora.

Data dhe ora automatike

Prek për të zgjedhur Përdor orën e mundësuar nga rrjeti ose Çaktivizo.

Ora automatike e rajonit

Prek për të përdorur zonën kohore të mundësuar nga rrjeti. Ose çaktivizoje atë për të vendosur të gjitha vlerat manualisht.

Vendos datën

Prek për të hapur një dialog ku mund të vendosësh manualisht datën e telefonit.

Vendos orën

Prek për të hapur një dialog ku mund të vendosësh manualisht orën e telefonit.

Zgjidh zonën orare

Prek për të hapur një dialog ku mund të vendosësh zonën orare të telefonit.

Përdor formatin 24 orë

Aktivizo  për të shfaqur orën duke përdorur format 24 orësh.

Zgjidh formatin e datës

Prek për të hapur një dialog ku mund të zgjedhësh formatin për shfaqjen e datave.

11.13.3 Rezervimi

Rezervimi në Google Drive

Prek dhe më pas ndërro ikonën  për të ruajtur automatikisht cilësimet e telefonit dhe të dhëna të tjera të aplikacioneve në serverët e Google, me llogarinë tënde të Google. Nëse zëvendëson telefonin, cilësimet dhe të dhënat që ke ruajtur do të restaurohen në telefonin e ri herën e parë që identifikohesh në llogarinë tënde të Google. Nëse shënon këtë opsion, ruhet një variacion i gjerë i cilësimeve dhe të të dhënave, duke përfshirë fjalëkalimet Wi-Fi, faqeshënuesit, një listë të aplikacioneve që ke instaluar, fjalët që ke shtuar në fjalor duke përdorur tastierën në ekran, si dhe shumicën e cilësimeve që konfiguron me aplikacionin Cilësimet. Nëse çaktivizon këtë opsion, do të ndalosh ruajtjen e cilësimeve të tua dhe çdo rezervim ekzistues fshihet nga serverët e Google.

11.13.4 Opsionet e rivendosjes

Rivendosja e Wi-Fi, lidhjes celulare dhe Bluetooth

Prek dhe shtyp butonin **RIVENDOS CILËSIMET** për të vendosur të gjitha cilësimet e rrjetit, duke përfshirë Wi-Fi, të dhënat Celulare dhe Bluetooth.

Rivendosja e preferencave të aplikacioneve

Prek **RIVENDOS APLIKACIONET** për të rivendosur të gjitha cilësimet e aplikacioneve, duke përfshirë aplikacionet e çaktivizuara, njoftimet e aplikacioneve, kufizimet e të dhënave në sfond për aplikacione etj.

Fshirja e të gjitha të dhënave (rivendosje në vlera fabrike)

Fshi të gjitha të dhënat e tua personale nga hapësira ruajtëse e brendshme e telefonit, përfshirë informacionin mbi llogarinë e Google, çdo llogari tjetër, cilësimet e sistemit dhe aplikacionit dhe çdo aplikacion të shkarkuar. Rivendosja e telefonit nuk do të fshijë përditësimet e softuerit që ke shkarkuar ose skedarët në kartën microSD, si p.sh. muzikën dhe fotot. Nëse rivendosja e telefonit kryhet në këtë mënyrë, do të të kërkohet të japësh sërish të njëjtin lloj informacioni si gjatë ndezjes së parë të Android.

Nëse nuk arrin të ndezësh telefonin, ka një mënyrë tjetër për të kryer një rivendosje në gjendje fabrike duke përdorur butonat e telefonit. Mbaj shtypur tastin Volumi lart dhe shtyp në të njëjtën kohë butonin e Energjisë derisa të ndizet ekrani.

11.13.5 Rregulloret dhe siguria

Prek për të shfaqur informacionin rregullator dhe të sigurisë, duke përfshirë modelin e produktit, emrin e prodhuesit, etj.

11.13.6 Rreth telefonit

Kjo përmban informacion rreth gjërave duke filluar nga informacioni ligjor, numri i modelit, versioni Android, versioni i bandës bazë, versioni kernel, numri i ndërtimit te ata të listuar më poshtë:

Statusi

Kjo përmban statusin e baterisë, nivelin e baterisë, statusin e kartës SIM, adresën IP, etj.

Informacioni ligjor

Prek që të shohësh informacion ligjor.

11.14 Përditësimet e softuerit

Përditësimet e softuerit mundësojnë shkarkimin e softuerëve të rinj për pajisjen tuaj, me synim përmirësimin e përvojës së përdoruesit dhe të performancës së produktit.

11.14.1 Kontrolli për përditësime

Prek për të kontrolluar për përditësim në versionet më të fundit softuerike.

11.14.2 Cilësimet

Vetëm me Wi-Fi

Prek  për të aktivizuar/çaktivizuar përditësimet e softuerit do të punojnë vetëm pasi të aktivizohet Wi-Fi.

Intervalet e kontrollit automatik

Prek për të zgjedhur intervalet që i lejojnë pajisjes të kontrollojë automatikisht për softuer të ri në intervale të zakonshme.

Shkarkimi automatik

Prek  për të aktivizuar/çaktivizuar shkarkimin automatik të softuerit kur të lidhet me Wi-Fi.

11.14.3 Ndihma

Prek për të mësuar informacione të mëtejshme rreth përditësimeve të softuerit.

12 Përditëso programin e telefonit

Duke përdorur instrumentin e përditësimit FOTA (Firmuer nëpërmjet ajrit), mund të përditësosh softuerin e telefonit.

Për të hapur **Përditësimet e softuerit**, prek **Cilësimet** > **Përditësimet e softuerit**. Prek **Kontrollo për përditësime** dhe telefoni do të kërkojë për softuerin më të fundit. Nëse do të përditësosh sistemin, prek **SHKARKO** dhe kurkjo të ketë mbaruar, prek **INSTALO** për të përfunduar përmirësimin. Tani telefoni do të ketë versionin më të fundit të softuerit.

Duhet të aktivizosh lidhjen e të dhënave përpara se të kërkosësh për përditësime. Disponohen cilësimet për intervalet e kontrollit automatik dhe kujtuesit e përmirësimeve sapo të rindezësh telefonin.

Nëse ke zgjedhur kontrollin automatik, kur sistemi zbulon një version të ri, ikona  do të shfaqet në shiritin e statusit. Prek njoftimin për të hyrë direkt te **Përditësimet e sistemit**.



Gjatë shkarkimit ose përditësimit të FOTA-s, mos ndrysho vendin e paracaktuar të hapësirës ruajtëse, për të shmangur gabimet në lokalizimin e paketës së saktë të përditësimit.

Lexo këtë informacion sigurie përpara se të përdorësh pajisjen. Zbatimi i paralajmërimeve do të ndihmojë që të parandalosh lëndimet ndaj vetes ose të tjerëve, si edhe dëmtimin e pajisjes.

Mund të jepen paralajmërime sigurie shtesë për përdorimin e aplikacioneve specifike në pajisje; duhet t'i zbatosh edhe këto udhëzime.

13 Piktoqramet dhe simbolet grafike



Lexo pjesën "Të dhëna për sigurinë" në këtë udhëzues përdorimi [në faqen 2] përpara se të përdorësh këtë pajisje. Në rast se nuk u përmbahesh paralajmërimeve të sigurisë kjo mund të rezultojë në lëndime të rënda.



Mos e përdorni gjatë furnizimit me karburant ose pranë gazit ose lëngjeve të ndezshme



Mos e përdor gjatë drejtimit të automjetit



Kjo pajisje mund të prodhojë një dritë të fortë ose pulsuese



Kur përdor telefonin afër trupit, sigurohu ta mbash një distance prej të paktën 5 mm



Mos e hidh në zjarr këtë pajisje ose baterinë e saj.



Kjo pajisje nuk është prodhuar për t'u përdorur nga fëmijët e vegjël. Nëse e lejon një fëmijë ta përdorë atë, sigurohu që fëmija të jetë nën mbikëqyrje të rreptë. Kjo pajisje përmban pjesë të vogla që përbëjnë rrezik mbytjeje



Shmang kontaktin me mjetet magnetike



Kjo pajisje mund të prodhojë tingull të lartë



Lejo temperaturat ekstreme



Mbaje larg nga stimuluesve kardiakë dhe pajisjeve të tjera mjekësore personale



Shmang kontaktin me lëngjet, mbaje të thatë



Fike kur kjo kërkohet në spitale dhe ambiente mjekësore



Mos provo ta çmontosh



Fike kur kjo kërkohet në avionë dhe aeroporte



Mos u mbështet te kjo pajisje për komunikime urgjence



Fike në ambiente shpërthyes



Përdor vetëm aksesore të miratuar



Mos e përdor këtë pajisje kur kalon rrugën ose kur je me biçikletë

Të dhëna për sigurinë e produktit

Ekspozimi ndaj frekuencave të radios (RF)

Deklaratë e përgjithshme rreth energjisë së frekuencave të radios

Telefoni yt përmban një radiodhënës dhe radiomarrës. Kur telefoni është ndezur, ai merr dhe transmeton energji RF. Kur komunikon me telefonin tënd, sistemi që trajton thirrjen kontrollon nivelin e fuqisë që transmeton telefoni.

Koeficienti Specifik i Absorbimit (SAR)

Pajisja jote celulare është një radio transmetuese dhe radio marrëse. Ajo është projektuar të mos kapërcejë kufijtë e ekspozimit ndaj valëve të radios të rekomanduara nga udhëzimet ndërkombëtare. Këto udhëzime janë hartuar nga organizata e pavarur shkencore (ICNIRP) dhe përfshijnë kufijtë e sigurisë të përcaktuar për të garantuar mbrojtjen e të gjithë personave, pavarësisht moshës dhe gjendjes shëndetësore.

Udhëzuesi përdor një njësi matëse të njohur si Koeficienti Specifik i Absorbimit ose SAR. Kufiri i SAR për pajisjet celulare është 2 W/kg dhe vlera më e lartë e SAR për këtë pajisje kur është testuar në vesh ishte 0,96 W/kg ⁽¹⁾ dhe kur është testuar afër trupit (në distancë prej 5 mm) vlera më e lartë SAR ishte 1,56 W/kg ⁽²⁾.

⁽¹⁾ Testimet janë kryer në përputhje me [CENELEC EN50360] [IEC 62209-1].

⁽²⁾ Testimet janë kryer në përputhje me [CENELEC EN50566] [IEC 62209-2].

Duke qenë se pajisjet celulare ofrojnë një gamë funksionesh, ato mund të përdoren në pozicione të tjera, si p.sh. në trup siç përshkruhet në këtë udhëzues përdorimi, shiko faqen 98 për më shumë informacion.

Vlera SAR është matur duke përdorur fuqinë maksimale të transmetimit të pajisjes dhe aty ku mbështetet me disa transmetues njëkohësisht. Vlera aktuale SAR e kësaj pajisjeje gjatë përdorimit është kryesisht nën vlerën e treguar më lart. Kjo ndodh për shkak të ndryshimeve automatike në nivelin e fuqisë së pajisjes për të siguruar që ajo përdor vetëm fuqinë minimale të nevojshme për të komunikuar me rrjetin.

Funksionimi i veshur në trup

Për të siguruar pajtueshmëri me direktivat e ekspozimit të RF, telefoni duhet të përdoret me një minimum prej 5 mm distancë nga trupi.

Në rast se nuk zbatohen këto udhëzime, mund të rezultojë që ekspozimi i RF të tejkalojë limitet përkatëse të direktivës dhe mund të përdoret më shumë fuqi se sa është e nevojshme.

Kufizimi i ekspozimit ndaj fushave të frekuencës radio (RF)

Për individët që shqetësohen rreth kufizimit të ekspozimit të tyre ndaj fushave të RF, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) ofron këshillën e mëposhtme në Fletën e fakteve 193 Fushat elektromagnetike dhe shëndeti publik: telefonat celularë (Tetor 2014)

Masat paraprake: Informacioni aktual shkencor nuk tregon nevojën për ndonjë masë të veçantë për përdorimin e celularëve. Nëse ka persona të shqetësuar, ata mund të zgjedhin ta kufizojnë ekspozimin e tyre ose të fëmijëve të tyre ndaj RF-ve duke kufizuar kohëzgjatjen e telefonatave ose duke përdorur pajisjet “pa duar” për t'i mbajtur celularët larg kokës dhe trupit.

Informacione të mëtejshme mbi ekspozimin ndaj valëve radio mund të merren nga OBSh <http://www.who.int/mediacentre/factsheets/fs193/en/>

14 Informacion rregullator

Miratimet dhe njoftimet e mëposhtme të sigurisë vlejnë në rajone specifike, siç është treguar më poshtë.

Përmes kësaj deklarate, Vodafone deklaron se pajisja e radios e llojit WFD 720 është në përputhje me Direktivën 2014/53/EU.

Teksti i plotë i deklaratës së konformitetit të BE-së disponohet në adresën e mëposhtme të internetit:

<http://vodafone.com/smartn9/ec-declaration>

Mbrojtja e të dhënave dhe përditësimet e softuerit

Duke vazhduar përdorimin e kësaj pajisjeje, ti tregon se ke lexuar dhe bie dakord me përmbajtjen e mëposhtme:

Për të ofruar shërbim më të mirë, kjo pajisje do të kontrollojë për/marrë përditësime softueri automatikisht nga Vodafone dhe partnerët e tij pas lidhjes me internetin. Ky proces mund të përdorë të dhënat celulare dhe kërkon akses në identifikuesin unik të pajisjes sate (IMEI/SN) dhe ID-në e rrjetit të ofruesit të shërbimit (PLMN) për të kontrolluar nëse pajisja ka nevojë të përditësohet.

Ki parasysh se as Vodafone dhe as partnerët e tij nuk do ta përdorin informacionin e IMEI/SN për të të identifikuar ty personalisht, por kjo bëhet vetëm për planifikimin/menaxhimin e përditësimeve të softuerit.

Tërheqja e vëmendjes

Përdorimi i një pajisjeje celulare për të komunikuar, dëgjuar muzikë ose për të parë media të tjera mund të tërheqë vëmendjen nga kryerja e aktiviteteve që kërkojnë vëmendje të plotë. Kjo gjithashtu mund të reduktojë ndërgjegjësimin tuaj rreth mjedisit rrotull jush.

Drejtimi i automjeteve

Drejtimit të automjeteve duhet t'i kushtohet në çdo kohë vëmendja e plotë për të ulur rrezikun e një aksidenti. Duke përdorur celular (edhe me një komplet përdorimi pa duar) shkakton tërheqje vëmendjeje dhe mund të çojë në një aksident. Duhet të jesh në pajtim me ligjet dhe rregulloret vendore që kufizojnë përdorimin e telefonave celularë gjatë drejtimit të automjeteve.

Përdorimi i makinerive

Përdorimit të makinerive duhet t'i kushtohet në çdo kohë vëmendja e plotë për të ulur rrezikun e një aksidenti.

Ecja dhe ngasja e biçikletës

Përdorimi i një pajisjeje celulare gjatë ecjes apo ngasjes së biçikletës ul përqendrimin te mjedisi rrotull teje dhe mund të rrisë rrezikun e aksidenteve.

Përdorimi i produktit

Deklaratë e përgjithshme mbi trajtimin dhe përdorimin

Ti je vetë përgjegjës sesi e përdor telefonin dhe për çdo pasojë të përdorimit të tij.

Gjithmonë duhet të fikësh telefonin kudo që përdorimi i një telefoni është i ndaluar. Përdorimi i telefonit u nënshtrohet masave të sigurisë të projektuara për të mbrojtur përdoruesit dhe mjedisin e tyre.

- Gjithmonë trajtoje telefonin dhe aksesorët e tij me kujdes dhe mbaje atë në një vend të pastër dhe pa pluhur.
- Mos e ekspozo telefonin ose aksesorët e tij në flakë të hapura ose në produkte të ndezura të duhanit.
- Mos e ekspozo telefonin ose aksesorët e tij ndaj lëngjeve, lagështisë apo lagështirës së lartë.
- Mos e shkund, hidh ose mos u përpiq ta përthyesh telefonin ose aksesorët e tij.
- Mos përdor kimikate të forta, tretës ose aerosolë për të pastruar pajisjen ose aksesorët e tij.

- Mos pikturo telefonin ose aksesorët e tij.
- Mos u përpiq ta çmontosh telefonin ose aksesorët e tij, vetëm personeli i autorizuar duhet të bëjë këtë.
- Mos e ekspozo telefonin ose aksesorët e tij në temperatura ekstreme, minimum -10 dhe maksimum +50 gradë Celsius.
- Kontrolllo rregulloret lokale për hedhjen e produkteve elektronike.
- Mos e mbaj telefonin në xhepin e pasmë sepse mund të thyhet kur ulesh.

Fëmijët e vegjël

Mos e lër telefonin dhe aksesorët e tij në një vend ku arrihen nga fëmijët e vegjël ose mos i lejo fëmijët të luajnë me to.

Ata mund të dëmtojnë veten ose të tjerët, ose aksidentalisht mund të dëmtojnë telefonin .

Telefoni përmban pjesë të vogla me tehe të mprehta që mund të shkaktojnë dëmtim apo mund të shpëputen dhe të krijojnë rrezik mbytjeje.

Demagnetizimi

Për të shmangur rrezikun e çmagnetizimit, mos lejo që pajisjet elektronike ose mjetet magnetike të qëndrojnë pranë telefonit për një kohë të gjatë.

Shmang burimet e tjera magnetike sepse ato mund të bëjnë që magnetometri i brendshëm dhe sensorë të tjerë të keqfunksionojnë dhe të japin të dhëna të pasakta.

Shkarkimi elektrostatik (ESD)

Mos prek lidhjet metalike të kartës SIM.

Furnizimi me energji


Mos e lidh pajisjen me furnizimin me energji ose mos e ndiz atë derisa të udhëzohesh për këtë në udhëzimet e instalimit.

Antena

Mos e prek antenën pa qenë nevoja.

Pozicioni normal i përdorimit me dorë

Kur kryen ose merr thirrje, mbaje telefonin te veshi, me fundin drejtuar te goja ose siç do të mbaje një telefon tradicional fiks.



Jastëkët e ajrit

Mos e vendos telefonin në zonën pranë ose mbi një jastëku ajri ose në zonën e aktivizimit të jastëkut të ajrit.

Ruaje telefonin në mënyrë të sigurt para se të drejtosh automjetin.

Konvulsionet/gjendjet e të fikët

Ky telefon është në gjendje të krijojë dritë pulsuese të shndritshme.

Lëndimet nga lëvizjet e përsëritura (RSI)

Për të minimizuar rrezikun e lëndimit nga tendosjet e përsëritura (RSI), kur shkruan mesazhe ose luan lojëra me telefonin:

- Mos e mbaj me dorë telefonin shumë fort
- Shtypi lehtë butonat ose ekranin
- Shfrytëzo funksionet speciale në telefon, të cilat minimizojnë numrin e butonave që duhen shtypur, si p.sh. modelet e mesazheve dhe tekstin parashikues
- Bëj shumë pushime për t'u shtendosur dhe për t'u çlodhur
- Nëse vazhdon të kesh shqetësime, ndalo përdorimin e kësaj pajisjeje dhe konsultohu me mjekun

Telefonatat e urgjencës

Ky telefon, si çdo telefon me valë, vepron duke përdorur sinjale radio, të cilat nuk garantojnë lidhje në të gjitha kushtet. Për këtë arsye, kurrë nuk duhet të mbështetesh vetëm në telefonat me valë për komunikimet e emergjencës.

Zhurma e lartë

Ky telefon është në gjendje të prodhojë zhurma të larta që mund të dëmtojë dëgjimin tënd.



MBROJTJA E DËGJIMIT

Për të parandaluar dëmtimin e mundshëm të dëgjimit, mos dëgjo në nivele të larta volumi për periudha të gjata. Ushtro kujdes kur mban pajisjen afër veshit ndërkohë që altoparlanti është në përdorim.

Funksioni i lexuesit të MP3-ve dhe videove

Gjatë dëgjimit të muzikës ose shikimit të videove në pajisje me kufje me volume të larta, ekziston rreziku i dëmtimit të përhershëm të dëgjimit. Edhe nëse je mësuar të dëgjosh muzikë me volum të lartë dhe të duket e pranueshme, sërish rrezikon të dëmtosh dëgjimin.

Ule volumin e zërit në një nivel të arsyeshëm dhe shmang përdorimin e kufjeve për periudha të gjata kohe për të shmangur dëmtimin e dëgjimit.

Kufje të ndryshme mund të transmetojnë volume më të larta ose më të ulëta volumi, me të njëjtin cilësim volumi në pajisjen tënde. Gjithmonë fillo me një cilësim të ulët volumi.

Mos dëgjo muzikë ose mos shiko video me kufje kur nget automjetin, kur nget biçikletën apo kur kalon rrugën.

Dëgjimi për një kohë të gjatë i muzikës, apo luajtja e lojërave ose përdorimi i përmbajtjeve të tjera nga pajisja për një kohë të gjatë dhe me volum të lartë, mund të sjellin dëmtim të dëgjimit.

Drita e fortë

Ky telefon është në gjendje të prodhojë pulsime drite ose të përdoret si elektrik, mos e përdor shumë pranë syve.

Nxehja e telefonit

Telefoni mund të nxehet gjatë karikimit dhe përdorimit normal, mos e përdor këtë telefon nëse ai mbinxehet (duke treguar një paralajmërim mbinxehjeje ose ndihet i nxehtë kur e prek).

Siguria elektrike

Aksesorët

Përdor vetëm aksesorët dhe karikuesit e miratuar.

Mos e lidh me produkte ose pajisje të papajtueshme.

Trego kujdes të mos prekësh ose lejosh që objekte metalike, si monedhat apo mbajtëset e çelësave, të kontaktojnë ose të krijojnë qark të shkurtër me terminalet e baterisë, karikuesin, pikën e karikimit të pajisjes ose çdo kontakt apo aksesor elektrik.

Mos e prek pajisjen me duar të lagura. Kjo mund të shkaktojë goditje elektrike.

Mos e prek kordonin e energjisë me duar të lagura ose mos e shkëput karikuesin duke tërhequr kordonin. Kjo mund të rezultojë në goditje elektrike.

Lidhja në një makinë

Kërko këshilla profesionale kur lidh një telefon fizik me sistemin elektronik të automjetit.

Produktet me defekt dhe të dëmtuara

Mos u përpiq të çmontosh telefonin ose aksesorët e tij.

Vetëm një personel i kualifikuar duhet të kryejë shërbimin ose riparimin e telefonit ose aksesorëve të tij.

Nëse telefoni ose aksesorët e tij bien në ujë ose lëngje të tjera, shpohen ose rrëzohen nga lartësi e madhe, mos i përdor derisa t'i kesh dërguar për kontroll në një qendër shërbimi të autorizuar.

Trajtimi dhe siguria e baterisë

Mos u përpiq të hapësh kapakun e pasmë dhe baterinë.

Bateria në këtë pajisje nuk mund të hiqet nga përdoruesi.

Mos u përpiq që ta heqësh baterinë apo të çmontosh pajisjen për të pasur qasje te bateria.

Përdor vetëm karikuesin që ke marrë, ose karikues zëvendësues të miratuar nga prodhuesi për t'u përdorur me pajisjen tënde. Përdorimi i karikuesve të tjerë mund të jetë i rrezikshëm.

Përdorimi i papërshtatshëm i pajisjes mund të rezultojë në zjarr, shpërthim ose rreziqe të tjera.

Nëse beson se bateria është dëmtuar, mos e ripërdor ose rikariko pajisjen dhe çoje te një qendër e autorizuar shërbimi për testim.

Mos e shpo apo shtyp baterinë ose mos ushtro ndaj saj presion ose forcë të jashtme.

Ndërhyrjet

Duhet treguar kujdes kur përdor telefonin në afërsi të pajisjeve personale mjekësore, të tilla si stimuluesit kardiakë dhe aparatet e dëgjimit.

Stimuluesit kardiakë

Prodhuesit e stimuluesve kardiakë rekomandojnë që të ruhet një distancë minimale prej 15 cm midis celularit dhe një stimuluesi kardiak për të shmangur një ndërhyrje të mundshme me stimuluesin. Për të arritur këtë përdore telefonin në veshin e krahut të kundërt të stimuluesit kardiak dhe mos e mbaj telefonin në xhep pranë gjoksit.

Pajisjet e dëgjimit

Personat me aparate dëgjimi ose implante të tjera dëgjimi mund të dëgjojnë zhurma interference gjatë përdorimit të pajisjeve me valë ose kur kanë pranë një të tillë.

Niveli i interferencës varet nga lloji i aparatit të dëgjimit dhe nga distanca nga burimi i interferencës dhe rritja e distancës midis tyre mund ta zvogëlojë interferencën. Mund të konsultohesh edhe me prodhuesin e pajisjes ndihmëse të dëgjimit për të diskutuar alternativat.

Pajisjet mjekësore

Konsultohu me mjekun dhe prodhuesin e pajisjes për të përcaktuar nëse përdorimi i telefonit mund të ndërhyjë në funksionimin e pajisjes mjekësore.

Spitalet

Fiki pajisjet me valë kur kjo kërkohet në spitale, në klinika ose në mjedise të kujdesit shëndetësor. Këto kërkesa janë hartuar për të parandaluar ndërhyrjet e mundshme me pajisjet e ndjeshme mjekësore.

Avionët

Mbylle pajisjen celulare kur të kërkohet ta bësh nga personeli i aeroportit ose i kompanisë ajrore.

Konsultohu me personelin e kompanisë ajrore rreth përdorimit të pajisjeve me valë në bordin e avionit dhe nëse pajisja jote ka "modalitetin e avionit", ky duhet aktivizuar përpara ngjitjes në bordin e avionit.

Interferenca në makina

Ki parasysh se për shkak të mundësisë së interferencave me pajisjet elektronike, disa prodhues automjesh e ndalojnë përdorimin e celularëve në makinat e tyre, përveç nëse është i përfshirë në instalim një sistem përdorimi pa duar me antenë të jashtme.

Ambientet shpërthyes

Pikat e karburantit dhe atmosfera shpërthyes

Në vende me atmosfera mundësisht shpërthyes vepro në përputhje me të gjitha shenjat e afishuara për të fikur pajisjet me valë, si p.sh. telefoni ose pajisje të tjera radio.

Zonat me atmosfera mundësisht shpërthyes përfshijnë zonat e rimbushjes me karburant, zonat poshtë kuvertës në varka, godinat e transferimit ose të magazinimit të karburantit ose të kimikateve dhe zonat ku ajri përmban kimikate ose grimca, si p.sh. kokrriza, pluhur ose pluhura metalesh.

Detonatorët dhe zonat e shpërthimit

Fike celularin ose pajisjen me valë kur je në një zonë shpërthimi ose në zona ku janë afishuar njoftime për fikjen e pajisjeve radio me "dy drejtime komunikimi" ose të "pajisjeve elektronike" për të shmangur interferencën me operacionet e shpërthimit.

Hedhja dhe riciklimi

Për të hedhur ose për të ricikluar pajisjen në mënyrë të sigurt dhe të përshtatshme, kontakto me qendrën e Shërbimit për Klientët për informacion.

Mbrojtja ndaj vjedhjes ⁽¹⁾

Telefoni yt identifikohet nga një IMEI (numër serial i telefonit) i treguar në etiketën e paketimit dhe në memorien e produktit. Ne rekomandojmë që ta mbash shënim numrin herën e parë që përdor telefonin, duke shtypur *#06# dhe ta ruash atë në vend të sigurt. Ky numër mund të kërkohet nga policia ose operatori nëse të vjedhin telefonin. Ky numër bën të mundur që celulari të bllokohet, duke penguar përdorimin e tij nga një person tjetër, qoftë edhe me kartë tjetër SIM.



Ky simbol në telefon, në bateri dhe aksesore do të thotë se këto produkte duhen dërguar në pikat e grumbullimit në fund të jetës së tyre:

- Qendrat e mbetjeve të bashkisë me kazanë specifike për këto lloje pajisjesh.
- Koshat e grumbullimit në pikat e shitjes.

Ato më pas duhet të riciklohen, duke parandaluar që lëndet të perhapen në mjedis dhe në mënyrë që përbërësit e tyre të mund të ripërdoren.

Në shtetet e Bashkimit Evropian:

Pikat e grumbullimit janë të arritshme pa pagesë.

Të gjitha produktet me këtë shenjë duhen dërguar në këto pika grumbullimi.

⁽¹⁾ Kontakto me operatorin e rrjetit për disponueshmërinë e shërbimit.

Në shtetet jashtë Bashkimit Evropian:

Artikujt e pajisjeve me këtë simbol nuk duhen hedhur në kazanët e zakonshëm nëse në juridiksionin ose rajonin ku ndodhesh ka fabrika të përshtatshme grumbullimi dhe riciklimi; përkundrazi ato duhet të dërgohen në pikat e grumbullimit që të riciklohen.

KUJDES: RREZIK SHPËRTHIMI NËSE BATERIA NDËRROHET ME NJË BATERI TJETËR TË NJË LLOJI TË GABUAR. HIDHI BATERITË E PËRDORURA NË PËRPUTHJE ME INSTRUKSIONET.

Nëse hiqet kapaku i baterisë, shmang kontaktin me antenat dhe kontaktet e antenave që përmbajnë nikel. Personat që janë alergjikë ose të ndjeshëm ndaj këtij metali duhet të shmangin kontaktin në çdo moment.

Licencat



Logoja microSD është markë tregtare.



Logot dhe marka e fjalës Bluetooth janë pronë e Bluetooth SIG, Inc. dhe çdo përdorim i këtyre markave nga TCL Communication Ltd. dhe filialet e saj është me licencë. Markat e tjera tregtare dhe emrat e tjerë tregtarë u përkasin zotëruesve të tyre përkatës.

VFD 720 ID-ja e deklaratës Bluetooth D038401



Logoja e Wi-Fi është një markë e certifikuar e Wi-Fi Alliance.

Kjo pajisje mund të përdoret në të gjitha vendet evropiane.

Kjo pajisje mund të përdoret pa kufizime në çdo shtet anëtar të BE-së.

Google, logoja e Google, Android, logoja e Android, Google Search TM, Google Maps TM, Gmail TM, YouTube, Google Play Store dhe Duo TM janë marka tregtare të Google Inc.

Roboti Android është riprodhuar ose modifikuar nga puna e krijuar dhe e publikuar nga Google dhe përdoret sipas kushteve të përshkruara në licencën Creative Commons 3.0 Attribution (teksti shfaqet kur prek dhe mban prekur **Shënimet ligjore të Google** te **Cilësimet > Rreth telefonit > Informacioni ligjor**) ⁽¹⁾.

Informacion i përgjithshëm

Ke blerë një produkt që përdor programe me burime të hapur (<http://opensource.org/>) (<http://opensource.org/>) mtd, msdosfs, netfilter/iptables dhe initrd në kodin e objektit dhe programe të tjera me burim të hapur, të licencuara me licencën GNU General Public Licence dhe Apache Licence.

Brenda një periudhe prej tre vjetësh nga shpërndarja e këtij produkti, ne mund të ofrojmë një kopje të plotë të kodeve përkatëse burimore, me kërkesën tënde nga adresa e mëposhtme në kapitullin Njoftim.

Mund t'i shkarkosh kodet burimore nga adresa <https://sourceforge.net/projects/alcatel/files/vfd720>. Sigurimi i kodit të burimit ofrohet falas nëpërmjet internetit.

Kjo pajisje radioje funksionon me brezat e frekuencës dhe fuqinë maksimale të radio-frekuencës si më poshtë:

GSM850/900: 33 dBm

GSM1800/1900: 30 dBm

UMTS 850/900/1900/2100: 24 dBm

LTE B1/3/5/7/8/20/28B: 24 dBm

Bluetooth: < 20 dBm

802.11bgn: Brezi 2,4 GHz < 20 dBm

NFC 13,56 MHz: < 25 dBuA/m në 10 m

Përshkrimi i aksesorëve dhe komponentëve, duke përfshirë softuerët, të cilët u lejojnë pajisjeve të radios që të funksionojnë sipas qëllimit të tyre, mund të gjenden në manualin e përdorimit të disponueshëm në adresën e mëposhtme të internetit:

⁽¹⁾ Kjo mund të mos jetë e disponueshme në varësi nga shteti ku jeton

<http://vodafone.com/smartn9/>

Njoftim

Informacioni në këtë manual mund të ndryshojë pa njoftim.

Megjithëse është bërë çdo përpjekje në përgatitjen e këtij manuali për të garantuar saktësinë e përmbajtjes, të gjitha deklaratat, informacionet dhe rekomandimet në këtë manual nuk përbëjnë garanci të asnjë lloji, të shprehur ose të nënkuptuar. Lexo masat e sigurisë dhe informacionin e sigurisë me kujdes për të garantuar që e përdor këtë pajisje me valë në mënyrë korrekte dhe të sigurt.

Importuesi: TCT Mobile Europe SAS

Adresa: 55, avenue des Champs Pierreux, 92000 Nanterre, France

Prodhuesi: Vodafone Procurement
Company S.a.r.l.



Markë e regjistruar tregtare:

Adresa: 15 rue Edward Steichen, L-2540 Luxembourg, Grand-Duché de Luxembourg

15 Informacioni i garancisë

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË GARANCISË

1. Vodafone merr përsipër garancinë e këtij celulari për një periudhë prej dy (2) vjetësh nga data e blerjes nga zotëruesi origjinal (jo të transferueshme) nën përdorim normal.
2. Bateria dhe karikuesi kanë një garanci të kufizuar për dymbëdhjetë (12) muajve dhe karikuesi për njëzet e katër (24) muaj kundër defekteve të prodhimit. Aksesori të tjerë kanë një garanci të kufizuar për njëzet e katër (24) muajve kundër defektet e prodhimit.
3. Kjo garanci nuk mbulon dëmtime që rezultojnë nga:
 - a) Konsumimi normal i pajisjeve;
 - b) Defekte dhe dëmtime për shkak se pajisja përdoret ndryshe nga mënyra normale dhe e zakonshme;
 - c) Kryerja e një çmontimi, riparimi, ndryshimi ose modifikimi të paautorizuar;
 - d) Keqpërdorimi, abuzimi, neglizhenca ose aksidenti, i shkaktuar nga kushdo;
 - e) Defekte ose dëmtime që lindin nga testimi i papërshtatshëm, mirëmbajtja, instalimi apo çdo ndryshim apo modifikim;
 - f) Defekte ose dëme për shkak të derdhjes së ushqimit ose lëngjeve, ndryshkut ose përdorimit të tensionit të gabuar;
 - g) Defekte ose dëme në sipërfaqen plastike dhe të gjitha pjesët e tjera të jashtme, të cilat janë shkaktuar nga ana e përdorimit normal nga klienti;
4. Nëse ky telefon ka nevojë për shërbim/riparim duhet të dorëzohet me shpenzimet e përdoruesit.
5. Kjo garanci do të jetë të pavlefshme në ndonjë nga rastet e mëposhtme:
 - a) Nëse numri i serisë ose vula e garancisë është dëmtuar ose është hequr nga pajisja.

- b) Nëse është ndryshuar ose modifikuar ndonjë prej kushteve të kësaj garancie në çfarëdo mënyre pa miratim paraprak me shkrim nga Vodafone.
6. Kjo garanci e kufizuar ofrohet vetëm për klientët që e blejnë produktin dhe është e vlefshme vetëm në vendin (ose zonën) e synuar të shitjes së produktit nga Vodafone.
7. Nëse produkti i kthehet Vodafone pas skadimit të periudhës së garancisë, do të zbatohen rregullat normale të shërbimit Vodafone dhe konsumatorit do t'i duhet të paguajë përkatësisht.
- a) Vodafone nuk merr përsipër ndonjë detyrim apo përgjegjësi tjetër përveç asaj që jepet shprehimisht për këtë garanci të kufizuar.
- b) Të gjitha informacionet për garancinë, karakteristika e produktit dhe specifikimet u nënshtrohen ndryshimeve pa njoftim.
8. KJO GARANCI JEPET NË VEND TË ÇDO GARANCIE TJETËR TË SHPREHUR OSE TË NËNKUPTUAR, VEÇANËRISHT DUKE PËRFSHIRË ÇDO GARANCI TË NËNKUPTUAR PËR TREGTUESHMËRI OSE PËRSHTATSHMËRI PËR NJË QËLLIM TË CAKTUAR. VODAFONE NUK PRANON ASNJË PËRGJEGJËSI PËR SHKELJEN E GARANCISË PËRTEJ KORRIGJIMIT TË SHKELJES NË MËNYRËN E PËRSHKRUAR MË LART. NË ASNJË RAST VODAFONE NUK DO TË JETË PËRGJEGJËSE PËR PASOJAT.

16 Aksesoret

Telefonat inteligjentë të fundit të Vodafone ofrojnë një funksion pa duar që lejon të përdorësh telefonin nga një distancë, vendosur në një tryezë për shembull. Për ata që preferojnë t'i mbajnë bisedat e tyre sekrete, disponohen kufjet.

1. Vodafone Smart N9 me bateri të integruar
2. Karikuesi
3. Kabllo të dhënash
4. Kufje
5. Udhëzues i shpejtë i përdorimit
6. Informacioni i sigurtisë dhe garancisë
7. Kunji për mbajtësen e SIM



Vetëm me baterinë, karikuesin dhe aksesoret në kutinë tënde.

17 Specifikime

Procesori:

MT6739 + 1.28GHz Quad core

Platforma:

Android O

Memoria:

16 GB+2GB RAM

Përmasat (LxGjxTh):

147,1 x 68,8 x 8,7mm

Pesha:

Rreth 145 gram me bateri

Ekrani:

Ekran me prekje 5,5 inç me rezolucion HD+ PLUS (720 x 1440)

Rrjeti:

GSM: Brez i katërfishtë 850/900/1800/1900 MHz

UMTS: Brez i katërfishtë 850/900/1900/2100 MHz

LTE: Brez i gjashtëfishtë (1/3/5/7/8/20/28B)

(Frekuenca e brezit dhe shpejtësia e të dhënave varet nga operatori.)

GPS:

Antenë ndihmëse GPS/GPS i brendshëm

Lidhshmëria:

- Bluetooth Smart (BT v4.2)

- Wi-Fi IEEE 802.11 b/g/n
- Fole audio 3,5 mm
- Micro USB 2.0

Kamera:

- Kamerë e pasme 13 megapikselë
- Kamera e përparme 8 megapiksel

Formatet e mbështetura të audios:

AAC/HE-AAC v1/HE-AAC v2, AMR, AWB, MIDI, MP2, MP3, OGG, Vorbis, WAV, APE, WMA, FLAC

Formatet e mbështetura të videos:

Luajtja: MPEG-4, H.264, H.263, H.265, MPEG2, VP8, VP9

Regjistrimi: MPEG-4, H.263, H.264, VP8

Bateria:

Bateri e rikarikueshme litiumi

Kapaciteti: 2900 mAh

Fole zgjerimi:

Fole karte memorie microSD (kapaciteti deri në 32 GB)

Veçoritë speciale:

Marrës GPS dhe akselerometër

Shënim: Specifikimet u nënshtrohen ndryshimeve pa njoftim paraprak.

Disa shërbime, funksione dhe aplikacione mund të mos ofrohen në të gjitha vendet. Pyet në dyqan për detaje.

Google, Android dhe marka të tjera janë marka të regjistruara tregtare të Google Inc. Roboti me Android riprodhohet ose modifikohet nga puna e krijuar dhe e ndarë nga Google e krijuar dhe e shpërndarë nga Google, si dhe përdoret në përputhje me kushtet e përshkruara në licencën Creative Commons 3.0 Attribution License.

© Vodafone Group 2018, Vodafone dhe stemat e logos janë marka tregtare të Vodafone Group. Emrat e produkteve apo të kompanive të tjera të përmendura në këtë dokument mund të jenë patentat markat tregtare të pronarëve përkatës.